



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYRA PROTOKOLL-ARKIVËS
Nr. 1852/2 Prot.
Datë: 26.11.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 19. 11. 2020

VENDIM

Nr. 53, datë 19. 11. 2020

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT ME KARAKTER
PROFESIONAL "UDHËRRËFYES TURISTIK PËR RAJONIN E JUGUT"**

Në mbështetje të nenit 49, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 25 i Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", Udhëzimit nr. 23, datë 28.09.2020 "Për një shtesë në Udhëzimin nr. 1 datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", të ndryshuar, si dhe propozimit të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Humane me nr.384 prot datë 30.10.2020 miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 83, datë 25.09.2020, në mbledhjen e datës 19.11.2020 Bordi i Administrimit,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Humane me shkresw nr. 384 prot, datë 30.10.2020 miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 83, datë 25.09.2020, për çeljen e programit të ri të studimit me karakter profesional "Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut", pranë departamentit të Gjuhëve të Huaja.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Dr. Ervis MOÇKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Nr. 126 / Prof.

Vlorë më, 11. 11. 2020

Lënda: Përcjellje propozimi për program të ri studimi "Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut"

BORDIT TË ADMINISTRIMIT

KËTU

I nderuar Kryetar i BA,
Të nderuar Anëtarë,

Referuar Udhëzimin nr. 1, datë 14 .01. 2020 *"Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësi kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë"*, bashkëlidhur po ju përcjell propozimin e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Humane për program të ri studimi "Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut" me shkresë nr. 384 prot, datë 30. 10. 2020, miratuar dhe me vendim Senati Akademik nr. 83, datë 25. 09. 2020, për miratim të mëtejshëm pranë Bordit të Administrimit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

REKTOR

Prof. Dr. Relana ZISI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
FAKULTETI I SHKENCËVE HUMANE
DEKANI

1775
0211

Nr. 384 Prot

Data 30 . 10 2020

Lënda: Përcjellje e propozimit për program të ri studimi për miratim nga Bordi i Administrimit

PROF.DR.ROLAND ZISIT, REKTOR I UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI",VLORË

I nderuar Zoti Rektor,


Bashkëlidhur po Ju përcjellim propozimin për program të ri studimi me karakter profesional "Udhërrefyes turistik për rajonin e jugut".

Programi ka marrë miratimin e Senatit Akademik (vendim nr. 83, datë 25.09.2020) dhe ka nevojë për miratim nga Bordi i Administrimit. Bashkëlidhur gjendet materiali i programit. Lutemi përcjelljen e këtij materiali për t'u marrë në shqyrtim nga ana e Bordit të Administrimit.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin e mirëkuptimin.

DEKAN

Prof. As. Armela Panajoti





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCËVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

- b) Të dhëna mbi kriteret e pranimit në këtë program studimi, tarifa dhe modalitetet financiare për studentët.

Kriteret e pranimit në programin e studimit.
Në programin e studimit me karakter profesional "Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut" kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë personat që: kanë përfunduar arsimin e mesëm, të përgjithshëm dhe/ose profesional.
Fusha e studimeve paraardhëse në rastet e programeve të ciklit të dytë
n/a
Numri maksimal i studentëve që do të pranohen
50 studentë
Tarifa e studimit
15.000 L
Politika e mbështetjes financiare për studentët (llojet e bursave nëse ka).
Bazuar në nenin 73, pika 1, shkronja f, studentët e Universitetit "Ismael Qemali" Vlorë kanë të drejtë "të përfitojnë bursë studimi kur plotësojnë kushtet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave si dhe shpërblime të veçanta që administrohen nga universiteti". Sipas VKM nr. 903, datë 21.12.2016, ndryshuar me VKM nr. 784, datë 26.12.2018, kategoritë që përfitojnë bursë dhe reduktim të tarifës së studimit janë: 1) Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihme ekonomike; 2) Bashkëshortët që kanë fëmijë dhe janë të dy studentë, përfitojnë secili bursë financiare; 3) Studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar; 4) Studentët që i kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar; 5) Studentët që i kanë të dy prindërit pensionistë ose njërin prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton; 6) Studentët, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë; 7) Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç; 8) Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç; 9) Studentët që janë identifikuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore, deri në moshën 25 vjeç;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCËVE HUMANË
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

- 10) Studentët që janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;
- 11) Studentët në vitin e parë akademik me notë mesatare vjetore nga 9 deri në 10 nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë dhe studentët në vitin pas të parit me mesatare vjetore të ponderuar nga 9 deri në 10 të vitit paraardhës akademik;
- 12) Studentët romë dhe egjiptianë;
- 13) Studentët, fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie;
- 14) Studentë në vitin e parë, me notë mesatare vjetore 9 deri 10, nga sistemi i arsimit të mesëm.

Kuota të dedikuara për studentë të kategorive të veçanta.

Shqiptarë nga trojet – 4 kuota

Grupet e marginalizuara (romë, egjiptianë etj.) – 4 kuota

Shtetas të huaj – 4 kuota

c) Plani mësimor/ Kurrikula e programit të studimit

Numri total i kreditëve	60 kredite
Pasqyrë analitike (për lëndë e module) e kurrikulës dhe krediteve si më poshtë:	
o Lëndë bazë (9 kredite)	
TUG 041 Teknika të udhërrëfimit turistik, 6 kredite	
Moduli 1: TUG 041-1 Teknika e parime të udhërrëfimit turistik, 4 kredite (1 leksion, 2 seminare)	
Moduli 2: TUG 041-2: Ndihma e shpejtë në udhërrëfim, 2 kredite (1 leksion, 1 seminar)	
Kompetenca(t)/Rezultatet e të nxënit ²⁰ të cilësive i/u përgjigjet: 1/1.1, 3.1.; 9/ 9.1, 9.2; 12/12.1, 12.2	
Përshkrim përmbledhës: Kjo lëndë trajton konceptet bazë të teknikave të udhërrëfimit në kushtet e një industrie turistike në rritje. Lënda është konceptuar për të shërbyer si një hyrje praktike në teknikat e udhërrëfimit: njohje me profesionin e udhërrëfyesit, cilësitë që duhet të zotërojnë, kodin e sjelljes, mënyrat dhe teknikat e udhërrëfimit, parimet, menaxhimin e situatave	

²⁰ Për kompetencat të cilave u përgjigjet programi, shih shtojcën 1.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

gjatë udhërrëfimit, dhënien e ndihmës së shpejtë në situata të caktuara e emergjente, itineraret, detyrat e udhërrëfyesit e çështje të tjera të lidhura me to.

DRE 042 Legjislacion për turizmin, 3 kredite (1 leksion, 1 seminar)

Kompetenca(t)/Rezultatet e të nxënit të cilës/ave i/u përgjigjet: 8/8.3

Përshkrim përmbledhës: Lënda "Legjislacioni për turizmin" pasqyron zhvillimet e rëndësishme legjislative që kanë ndodhur në vendin tonë në fushën e turizmit. Vëmendje e veçantë u kushtohet çështjeve që lidhen me njohuritë për të drejtën dhe ligjin në fushën e turizmit, njësi akomoduese, agjencive turistike dhe të udhëtimit në legjislacionin shqiptar dhe atë të Bashkimit Evropian.

Çështje të veçantë do t'u kushtohet Ministrisë përgjegjëse për turizmin, ATA, Unionit të operatorëve turistikë, mbrojtjes së konsumatorit turistik etj.

o Lëndë karakterizuese (32 kredite)

ENG 031 Anglishte për turizmin 1 (B2), 4 kredite (4 seminare)

Kompetenca(t)/Rezultatet e të nxënit të cilës/ave i/u përgjigjet: 4/4.1, 4.2; 5/5.1., 5.2.; 6/6.1, 6.2; 7/7.1

Përshkrim përmbledhës: Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në programet e gjuhës angleze, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale. Niveli i njohurive i përkët nivelit B2 sipas dokumentit evropian "Kuadri i Përbashkët Evropian i referencave për Gjuhët". Synon, ndër të tjera:

- Të aftësojë studentët në përdorimin e gjuhës për të komunikuar, për të përmbushur interesat e tij personale si dhe për të plotësuar kërkesat specifike të profesionit.
- Të ndërgjegjësojë studentin për aspektet kulturore dhe të reflektojë mbi ndryshimet mes praktikave kulturore të vendit ku flitet gjuha e huaj dhe kulturës amtare duke analizuar aspekte të kulturave.
- Të zhvillojë më tej aftësinë komunikuese dhe përdorimin e njohurive gjuhësore në situata praktike të profesionit.
- Të konsolidojë bashkëveprimin ndërmjet punës në grup dhe punës së pavarur individuale dhe krijuese edhe me folës të gjuhës të cilën ai mëson.

ENG 032 Anglishte për turizmin 2 (C1), 4 kredite (4 seminare)

Kompetenca(t)/Rezultatet e të nxënit të cilës/ave i/u përgjigjet: 4/4.1, 4.2; 5/5.1., 5.2.; 6/6.1, 6.2; 7/7.1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

Përshkrim përmbledhës: Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në programet e gjuhës angleze, të cilat përcaktojnë njohuritë dhe shprehjet e domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale. Niveli i njohurive i përket nivelit C1 sipas dokumentit evropian "Kuari i Përbashkët Evropian i referencave për Gjuhët".

Ky program synon:

- të ngrejë në një nivel më të lartë mësimin e kësaj gjuhë, si edhe të thellojë më tej e të përafrojë të nxënësit e saj me pranë vendeve anglishtfolëse. Përdorimi i metodave e praktikave bashkëkonore të mësimin të anglishtes dhe bashkërendimi i strategjive shërbejnë që studenti:
- të thellojë më tej pavarësinë dhe individualitetin intelektual dhe kulturor;
- të thellojë më tej njohuritë e marra dhe të nxisë krijimtarinë dhe mënyrën alternative të të menduarit;
- të ndërgjegjësohet për veçoritë kulturore të vendeve anglishtfolëse dhe praktikave gjuhësore në kontekste të ndryshme në turizëm.

Gjuhë e huaj 1 (Zgjidh një nga: ITA 031 Italisht (B2)/FRE 031 Frëngjisht (B2)/GER 031 Gjermanisht (B2)/SPA 031 Spanjisht (B2)), 4 kredite (4 seminare)

Kompetenca(t)/Rezultatet e të nxënësit të cilës/ave t'u përgjigjet: 4/4.1, 4.2; 5/5.1., 5.2.; 6/6.1, 6.2; 7/7.1

Përshkrim përmbledhës: Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimin dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Synimet e kursit janë:

- zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe jolettrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;
- forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit B2 në një nga gjuhët e përzgjedhura më sipër.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

Gjuhë e huaj 2 (Zgjidh një nga: ITA 432 Italisht (C1)/FRE 432 Frëngjisht (C1)/GER 432 Gjermanisht (C1)/SPA 432 Spanjisht (C1)), 4 kredite (4 seminare)

Kompetenca(t)/Rezultatet e të nxënit të cilës/ave i/u përgjigjet: 4/4.1, 4.2; 5/5.1., 5.2.; 6/6.1, 6.2; 7/7.1

Përshkrim përmbledhës: Programi është hartuar në përputhje me Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (KPER) dhe synon të arrijë dhe të realizojë standardet e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit, me qëllim që t'i përgjigjet një shoqërie të hapur sipas kërkesave dhe nevojave që shtrohen përpara mësimi dhe përvetësimit të gjuhës së huaj në vendin tonë.

Synimet e kursit janë:

- zhvillimi i aftësive për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi nëpërmjet këtyre teksteve i mendimit kritik e krijues;
- përdorimi i gjuhës dhe mjeteve të saj në varësi të situatës dhe qëllimit që kanë studentët;
- gjetja, kuptimi, analiza dhe vlerësimi informacioneve;
- respektimi i traditave dhe vlerave të kulturave të ndryshme;
- forcimi i ndërveprimit në situata reale, lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe shkëmbimi i informacioneve të detajuara mbi tema që paraqesin interes për studentin;
- thellimi i njohurive gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse, përmes të cilave studenti zgjeron njohuritë për botën dhe, në të njëjtën kohë, formohet intelektualisht.

Kursi është i konceptuar që ta çojë studentin drejt nivelit C1 në një nga gjuhët e përzgjedhura më sipër.

GEO 050 Gjeografia e turizmit, 6 kredite

Moduli 1: GEO 050-1 Gjeografi e rajonit të jugut, 3 kredite (1 leksion, 1 seminar)

Moduli 2: GEO 050-2 Karakteristika të zhvillimit të turizmit në rajonin e jugut, 3 kredite (1 leksion, 1 seminar)

Kompetenca(t)/Rezultatet e të nxënit të cilës/ave i/u përgjigjet: 8/8.1

Përshkrim përmbledhës: Turizmi është bërë këto vitet e fundit objekt studimi i shumë shkencave edhe në Shqipëri. Vend të rëndësishëm ka marrë studimi gjeografik i turizmit.

Synimet kryesore rreth asimilimit të këtij programi nga studentët orientohen në:

- Ofertën turistike (bazat natyrore dhe kulturore të hapësirave gjeografike për zhvillimin e tyre turistik).
- Kërkesën turistike (format e lëvizjes turistike, prejardhja dhe struktura sociale e turistëve etj).
- Historinë e zhvillimit të turizmit.
- Nevojën parashikuese për sipërfaqe pushimi, argëtimi dhe shlodhje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

- Vendet dhe rajonet turistike (analiza cilësore e tyre, tipizimi etj).
- Rëndësinë ekonomike të turizmit.
- Mundësitë e rregullimit dhe planifikimit të hapësirës nëpërmjet turizmit.
- Analizën e shkaqeve, faktorëve dhe kushteve shoqërore për zhvillimin e turizmit.
- Përcaktimi dhe klasifikimi i rajoneve turistike.
- Analiza e hapësirave turistike model nën ndikimin e grupeve të caktuara demografike e sociale.
- Analiza e efekteve lokale dhe rajonale të turizmit.
- Analiza e ngarkesave ekologjike dhe sociale të krijuara nga turizmi.
- Studimi i elementeve bazë të zhvillimit lokal dhe rajonal të turizmit.
- Ekoturizmi, përmbajtja, parimet, përparësitë, kufizimet dhe mbrojtja.
- Zhvillimet rajonale të turizmit në botë dhe në Shqipëri.

HIS 051 Histori e qytetërimit shqiptar, 4 kredite (2 leksione, 1 seminar)

Kompetenca(t)/Rezultatet e të nxënit të cilës/ave i/u përgjigjet: 8/8.1.

Përshkrim përmbledhës: Lënda "Histori e qytetërimit shqiptar" synon t'u japë studentëve njohuri bazë për konceptin e 'qytetërimit shqiptar'. Fillimisht ai do të trajtohet nga pikëpamja teorike dhe pastaj do të synohet që koncepti i 'qytetërimit shqiptar' të shpjellohet edhe si ligjërime dhe i lidhur ngushtë me atë që shihet si 'identiteti kombëtar'. Mendojmë se një qasje e tillë do t'u japë studentëve mundësinë ta shohin qytetërimin shqiptar si një dukuri të lëvizshme, që nuk është statike, por që është gjithmonë në një proces formulimi dhe riformulimi. Nga ana tjetër, një qasje e tillë do të mund të tregojë se ajo që shpesh përfytyrohet si 'qytetërim shqiptar' i dhënë një herë e përgjithmonë është në të vërtetë produkt i shtresëzimeve kulturore të ndryshme që vijnë përgjatë shekujve.

ALB/HIS 040 Trashëgimi natyrore e kulturore, 6 kredite

Moduli 1: ALB/HIS 040-1 Trashëgimi natyrore e rajonit të jugut, 3 kredite (1 leksion, 1 seminar)

Moduli 2: ALB/HIS 040-1 Arkeologji dhe trashëgimi kulturore e rajonit të jugut, 3 kredite (1 leksion, 1 seminar)

Kompetenca(t)/Rezultatet e të nxënit të cilës/ave i/u përgjigjet: 8/8.1

Përshkrim përmbledhës: Kursi 'Trashëgimi natyrore e kulturore' është konceptuar si një kurs hyrës, i ndarë në dy module, për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë. Në këtë kurs, do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me pasuritë natyrore, kulturore dhe trashëgimore të popullit shqiptar, arkeologjinë, porë në kontekstin e turizmit dhe asaj që



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

është tërheqëse dhe ngjall interes tek turistët dhe vizitorët e huaj, por jo vetëm.

Ky kurs do t'i afësojë studentët që të:

- mendojnë në mënyrë kritike për historinë, qytetërimin, kulturen dhe artin shqiptar.
- identifikojnë qasjet dhe veçoritë karakteristike të trashëgimisë natyrore e kulturore shqiptare.
- kultivojnë shijen dhe gjykimin për objekte të trashëgimisë natyrore e kulturore shqiptare.
- të kuptojnë fillesat e zhvillimeve kulturore dhe historike shqiptare.

◦ **Lëndë ndërdisiplinore/karakterizuese (8 kredite)**

COM 052 Hyrje në komunikimin ndërkulturor, 4 kredite (2 leksione, 1 seminar)

Kompetenca(t)/Rezultatet e të nxënit të cilës/ave i/u përgjigjet: 2/2.1, 2.2.; 11/11.1, 11.2, 11.3, 11.4

Përshkrim përmbledhës: Kursi 'Hyrje në komunikimin ndërkulturor' është konceptuar si një kurs hyrës për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë. Në këtë kurs, do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me ndërveprimin e njerëzve nga sfonde të ndryshme kulturore dhe gjuhësore, sidomos në një kontekst të gjerë e të diversifikuar të shenjuar nga zhvillimet e teknologjisë, globalizimi dhe lëvizjet migratore. Të rinjtë gjithnjë e më shumë zgjedhin të studiojnë në një vend të ndryshëm nga i tyre, ndër të tjera edhe për të marrë një përvojë të re kulturore. Në këto kushte, nevoja për përshtatje dhe ndërtim të marrëdhënieve ndërkulturore bëhet edhe më e madhe. Ky kurs jep shprehje bazë të të kuptuarit të kompleksitetit të komunikimit gjuhësor dhe ndërkulturor në vendndodhje të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Rrit ndërgjegjësimin për domethënien që merr anglishtja si *lingua franca* në një botë gjithnjë edhe më të globalizuar dhe të ndërlikuar, si dhe nënvizon rëndësinë e njohjes së gjuhëve të tjera në këto kushte. Në këtë kurs paraqiten koncepte bazë të komunikimit ndërkulturor, duke vënë theksin tek zhvillimet historike në këtë fushë.

Zgjidh një nga:

ALB/HIS 054 Etnokulturë e trevave të jugut/ART/HIS 055 Enogastronomi e trevave të jugut, 4 kredite (2 leksione, 1 seminar)

Kompetenca(t)/Rezultatet e të nxënit të cilës/ave i/u përgjigjet: 2/2.1, 2.2.; 11/11.1, 11.2, 11.3, 11.4; 10/10.1, 10.2, 10.3

Përshkrim përmbledhës:

Etnokulturë e trevave të jugut është një kurs i projektuar për studentët e këtij programi, i cili synon t'i njohë ata me elementet kryesore të etnokulturës së pasur të trevave të jugut që paraqesin interes për vizitorët vendas e të huaj. Në këtë kurs, studenti do të marrë njohuri rreth traditave e zakoneve të trevave të jugut, veshjet, festimet, këngët, vallet, folklorit etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKËNCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

Enogastronomi e trevave të jugut është konceptuar si një kurs hyrës për studentët e këtij programi, të cilët njihen për herë të parë me këtë lëndë, e cila studion raportet mes territorit dhe veprimtarive njerëzore që lidhen me produktet e tokës, kryesisht ushqime dhe pije. Në këtë kurs, do të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me traditat kulinare, gastronomike e traditat e prodhimit, shijimit e vlerësimit të pijeve tradicionale të trevave të jugut.

o **Lëndë plotësuese (6 kredite)**

CST 046 Përdorimi i TIK në udhërrëfim, 2 kredite (1 leksion, 1 seminar)

Kompetenca(t)/Rezultatet e të nxënës të cilës/ave i/u përgjigjet: 3/3.1.; 10/10.1

Përshkrim përmbledhës: Në këtë kurs synohet të jepet njohuri mbi teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit në turizëm dhe komunikim për qëllime turistike në mënyrë që studentët të fitojnë njohje dhe kompetenca përdorimi të TIK në procesin e promovimit të turizmit dhe ofrimit të shërbimeve në turizëm për ta bërë atë sa më efektiv. Lënda do të synojë në mënyrë specifike të aftësojë studentin që të integrojë mjetet kryesore që ofron TIK në komunikimin për qëllime turistike, si p.sh. mediet sociale, blogjet, faqet web etj.

TUG 090 Praktikë profesionale, 6 kredite

Kompetenca(t)/Rezultatet e të nxënës të cilës/ave i/u përgjigjet: 9/9.1, 9.2

Përshkrim përmbledhës: Programi që zhvillohet nëpërmjet lëndës "Praktikë profesionale" paraqet interes për studentët e programit, pasi do të konkretizojnë, prekin, perceptojnë gjithë njohuritë e tyre teorike rreth potencialeve turistike (natyrore dhe kulturore) të vendit tonë.

Shqipëria, vend me pasuri të shumta natyrore e kulturore-historike. Ndërtim gjeologjik i larmishëm, klimë e shumëllojshme dhe hidrografi e pasur, botë bimore dhe shtazore e shumëllojshme (zona me status të ndryshëm mbrojtjeje, sipas IUCN). Ofertë e larmishme turistike (arkeologjike, etnografike, historike, fetare etj.).

Praktika mësimore e studimit në terren ka si qëllim dhe synim të pajisë studentët me njohuri të drejtpërdrejta të veçorive natyrore dhe historik-kulturore të hapësirave gjeografike të përcaktuara, si dhe tregues e dëshmi të përvojës më të rëndësishme historike e politiko-kulturore të periudhave të ndryshme historike në vendin tonë.

Synimet kryesore rreth asimilimit të këtij programi nga studentët orientohen në:

-Ofertën turistike (bazat natyrore dhe kulturore të hapësirave gjeografike për zhvillimin e tyre turistik)

-Zonat më tipike natyrore me potenciale turistike dhe ato historiko-kulturore.

-Zonat me status të ndryshëm mbrojtjeje (njohja, studimi, mbrojtja, problematikat që hasin, mundësi të për zhvillimin e turizmit).

o **Detyrime përmblylëse (3 kredite)**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

TUG 089 Provim përfundimtar, 3 kredite

Kompetenca(t)/Rezultatet e të nxënit të cilës/ave i/u përgjigjet: Të gjitha

Përshkrim përmbljedhës: Studentët diplomohen me provim të përgjithshëm.

Provimi i përgjithshëm realizohet me shkrim dhe me gojë. Provimi me shkrim teston nivelin gjuhësor të studentit (CI) përmes ushtrimeve gjuhësore (gramatikore dhe leksikore) dhe aftësinë e të mendurit kritik dhe argumentimit përmes leximit dhe shkrimit duke u paraqitur atyre tekste turistike dhe situata profesionale të udhërrëfimit për të shtjelluar. Provimi me gojë ndërtohet në formën e intervistës me pyetje nga disiplina themelore në programin e studimit. Vlerësimi përfundimtar përfshihet nga mesatarja e të dy vlerësimeve bashkë.

ç) Personeli akademik dhe ndihmësakademik

Numri i personelit akademik në njësinë bazë	8 pedagogë me kohë të plotë
Numri i personelit akademik që i dedikohet programit të studimit (personel me kohë të plotë/pjesshme)	16 pedagogë me kohë të plotë
Numri i personelit akademik të përfshirë përgjegjës për lëndët karakterizuese (personel me kohë të plotë/pjesshëm)	8 pedagogë me kohë të plotë
CV e shkurtuara të personelit akademik që do të angazhohet në program (titulli/grada, fusha e ekspertizës kërkimore)	Armela Panajoti <i>Kategoria:</i> profesor <i>Titulli akademik/grada shkencore:</i> profesor i asociuar <i>Fusha e specializimit të pedagogut/drejtimi:</i> letërsi/letërsi angleze <i>Veprimtaria kërkimore e pedagogut e përqendruar në</i> lexime të larmishme të veprave letrare nga letërsia angleze dhe amerikane kryesisht nën këndvështrimin e teorisë post-strukturaliste si dekonstruksioni, psikanaliza, teoritë post-koloniale etj. Ndër interesat shkencore më të fundit kanë qenë çështje të komunikimit ndërkulturor, semiotikës në kulturë, kulturës për qëllime të mësimdhënies, edukimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

	ndërkulturor, etikës në kërkim etj. <i>Kurset që ka zhvilluar/zhvillon:</i> Hyrje në teorinë e letërsisë, Letërsi angleze, Kërkim në edukim, Kulturë dhe qytetërim i vendeve anglofone, Komunikim ndërkulturor <i>Përvoja në mësimdhënie:</i> Staf akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja që prej 1999.
	Frosina Londo (Qyrdeti) <i>Kategoria:</i> profesor <i>Titulli akademik/gradë shkencore:</i> profesor i asociuar <i>Fusha e specializimit të pedagogut/drejtimit:</i> mësimdhënie/didaktikë <i>Veprintaria kërkimore e pedagogut e përqendruar në</i> çështje të mësimdhënies së gjuhës italiane, aspekte kulturore të saj, letërsisë (shkrimtarë arbëreshë apo shqiptarë që jetojnë në Itali), tematika të tjera kulturore si emigracioni, media etj. <i>Kurset që ka zhvilluar/zhvillon:</i> Hyrje në teorinë e letërsisë për gjuhën italiane, Sociolinguistikë, Kërkim në edukim, Kulturë dhe qytetërim italian, Bazat kulturore të edukimit (për gjuhën italiane) <i>Përvoja në mësimdhënie:</i> Staf akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja që prej 1998.
	Meri Gjoleka <i>Kategoria:</i> profesor <i>Titulli akademik/gradë shkencore:</i> profesor i asociuar <i>Fusha e specializimit të pedagogut/drejtimit:</i> gjuhësi/gjuhësi e krahasuar <i>Veprintaria kërkimore e pedagogut e përqendruar në</i> çështje të përdorimit të lidhës, bilinguizmit, dialekteve, psikolinguistikës etj. <i>Kurset që ka zhvilluar/zhvillon:</i> Gjuhësi e përgjithshme për gjuhën italiane, Hyrje në gjuhësi për gjuhën italiane, Italisht I, Psikolinguistikë dhe përvetësim i gjuhës së dytë <i>Përvoja në mësimdhënie:</i> Staf akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja që prej



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

	2001. Anila Hima <i>Kategoria:</i> lektor <i>Titulli akademik/gradë shkencore:</i> doktor i shkencave <i>Fusha e specializimit</i> të pedagogut/drejtimit: gjuhësi/sociolinguistikë, gjuha dhe gjinia <i>Veprimtaria kërkimore</i> e pedagogut e përqendruar në çështje të formave të veçanta të ligjërimit, kryesisht atij me karakter gjinor. <i>Kurset që ka zhvilluar/zhvillon:</i> sociolinguistikë, gjermanisht, metoda të kërimit në përkthim. <i>Përvoja në mësimdhënie:</i> Staf akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja që prej 2011. Ledina Merkaj <i>Kategoria:</i> lektor <i>Titulli akademik/gradë shkencore:</i> doktor i shkencave <i>Fusha e specializimit</i> të pedagogut/drejtimit: gjuhësi/studime të komunikimit, përkthim <i>Veprimtaria kërkimore</i> e përqendruar në çështje nga më të ndryshmet, spikasin ato që lidhen me komunikimin, sidomos atë kulturor dhe ndërkulturor, aspekte të përkthimit, identitetit kulturor, çështje gjuhësore në ligjërimin turistik etj. <i>Kurset që ka zhvilluar/zhvillon:</i> studime të komunikimit, anglisht, anglishte ligjore <i>Përvoja në mësimdhënie:</i> Staf akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja që prej 2011. Zamira Alimemaj <i>Kategoria:</i> lektor <i>Titulli akademik/gradë shkencore:</i> doktor i shkencave <i>Fusha e specializimit</i> të pedagogut/drejtimit: gjuhësi/gramatikë/etnolinguistikë <i>Veprimtaria kërkimore</i> e pedagogut e përqendruar në çështje të drejtshkrimit, leksikut, gjallëformimit, emrave të përveçëm, elementeve të ndryshëm etnografikë në ligjërim. <i>Kurset që ka zhvilluar/zhvillon:</i> gramatikë e gjuhës
--	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

	angleze, anglishte e avancuar, anglishte biznesi, anglishte ligjore <i>Përvoja në mësimdhënie:</i> Staf akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja që prej 1998.
	Bardhosh Gaçe <i>Kategoria:</i> profesor <i>Titulli akademik/gradë shkencore:</i> profesor <i>Fusha e specializimit</i> të pedagogut/drejtimit: letërsi/letërsi shqipe <i>Veprimtaria kërkimore</i> e pedagogut e përqendruar në çështje të letërsisë shqipe, traditës, trashëgimisë kulturore, etnografisë, turizmit kulturor etj. Ka një kontribut të çmuar në lartësimin e vlerave kulturore e historike të qarkut e më tej. Hartues i guidave për Vlorën dhe Shqipërinë. <i>Kurset që ka zhvilluar/zhvillon:</i> Letërsi shqipe I, Etnofolklor, Antropologji kulturore, Etnologji, Letërsi shqipe, Letërsi për fëmijë, Turizëm kulturor <i>Përvoja në mësimdhënie:</i> Staf akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë që prej 1998.
	Fatllinda Shkurti <i>Kategoria:</i> lektor <i>Titulli akademik/gradë shkencore:</i> doktor i shkencave <i>Fusha e specializimit</i> të pedagogut/drejtimit: gjeografi <i>Veprimtaria kërkimore</i> e pedagogut e përqendruar në çështje të gjeografisë, territorit, popullatës, migrimit, rolit të lëvizjeve demografike etj. <i>Kurset që ka zhvilluar/zhvillon:</i> Gjeografi fizike e përgjithshme, Gjeografi e didaktikë, Gjeografi fizike e Shqipërisë, Gjeografi turizmi, Mësimdhënie e histori-gjeografisë <i>Përvoja në mësimdhënie:</i> Staf akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Edukimit që prej 2007.
	Esmeralda Laçi <i>Kategoria:</i> lektor <i>Titulli akademik/gradë shkencore:</i> doktor i shkencave <i>Fusha e specializimit</i> të pedagogut/drejtimit: gjeografi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

	<i>Veprimtaria kërkimoree pedagogut e përqendruar në çështje të gjeografisë, territorit, mjedisit urban etj.</i> <i>Përvojë si këshilltars për turizmin, Qarku Fier dhe si guidë turistike, përkthyes për agjencinë 'Albanian Holidays'.</i> <i>Kurset që ka zhvilluar/zhvillon:</i> Gjeografia ekonomike-politike e botës, Gjeografia Humane e Shqipërisë, Gjeografia e Turizmit, Politikat Mjedisore, Gjeografia e Popullsisë <i>Përvoja në mësimdhënie:</i> Staf akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Edukimit që prej 2014.
	Enkelejda Billa <i>Kategoria:</i> lektor <i>Titulli akademik/grad shkencore:</i> doktor i shkencave <i>Fusha e specializimit të pedagogut/drejtimi:</i> histori <i>Veprimtaria kërkimoree pedagogut e përqendruar në çështje të historisë së Shqipërisë, migrimit, vlerave kulturore dhe turistike, figurave të rëndësishme kombëtare etj.</i> <i>Kurset që ka zhvilluar/zhvillon:</i> Histori Shqipërie, Histori Moderne Botërore, Histori Ballkani, Bazat e Edukimit Kulturor, Turizëm kulturor, Histori Arti <i>Përvoja në mësimdhënie:</i> Staf akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Edukimit që prej 2013.
	Aulona Haxhiraj <i>Kategoria:</i> lektor <i>Titulli akademik/grad shkencore:</i> doktor i shkencave <i>Fusha e specializimit të pedagogut/drejtimi:</i> shkenca juridike <i>Veprimtaria kërkimoree pedagogut e përqendruar në çështje të të drejtave civile dhe politike, legjislacionit, integritetit evropian etj.</i> <i>Kurset që ka zhvilluar/zhvillon:</i> Të drejtat e njeriut, E drejtë Evropine, Gjykimet Administrative, E drejtë Mjedisë, Histori Institucionesh <i>Përvoja në mësimdhënie:</i> Staf akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Drejtësisë që prej 2011.
	Ronedë Muçaj <i>Kategoria:</i> lektor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

	<i>Titulli akademik/gradë shkencore:</i> doktor i shkencave <i>Fusha e specializimit të pedagogut/drejtimit:</i> shkencë kompjuterike/kërkime operacionale <i>Veprimtaria kërkimoree pedagogut e përqendruar në</i> çështje të sistemeve inteligjente, TIK në mësimdhënie; fertilitetit të modelimit etj. <i>Kurset që ka zhvilluar/zhvillon:</i> Hyrje në Inteligjencën Artificiale; Inteligjenca Artificiale; Projektimi dhe Analiza e Algoritmave <i>Përvoja në mësimdhënie:</i> Staf akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Shkencave Kompjuterike që prej 2008.
	Xhuljana Xhindoli <i>Kategoria:</i> lektor <i>Gradë shkencore:</i> Doktor i shkencave <i>Fusha e specializimit të pedagogut/drejtimit:</i> infermieri <i>Veprimtaria e pedagogut e përqendruar në</i> çështje të kujdesit shëndetësor, urgjencave mjekësore, ndihmës së parë. <i>Kurset që ka zhvilluar/zhvillon:</i> Principet e Infermierisë I, Infermiera për adultin, Urgjenca mjekësore <i>Përvoja në mësimdhënie:</i> Staf akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Kujdesit Shëndetësor.
	Ana Çano <i>Kategoria:</i> Asistent-lektore <i>Gradë shkencore:</i> Master i Shkencave <i>Fusha e specializimit të pedagogut/drejtimit:</i> gjuhësi/komunikim ndërkulturor e turistik <i>Veprimtaria e pedagogut e përqendruar kryesisht në</i> çështje kulturore. <i>Kurset që ka zhvilluar/zhvillon:</i> spanjisht <i>Përvoja në mësimdhënie:</i> Staf akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja që prej 2014.
	Adriana Gjika <i>Kategoria:</i> Asistent-lektore <i>Gradë shkencore:</i> Master i Shkencave <i>Fusha e specializimit të pedagogut/drejtimit:</i> didaktikë e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

	gjuhës frënge Veprimtaria e pedagogut e përqendruar në çështje nga mësimdhënia e gjuhës frënge. <i>Kurset që ka zhvilluar/zhvillon:</i> gjuhë frënge, kulturë dhe qytetërim francez <i>Përvoja në mësimdhënie:</i> Staf akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja që prej 1997.
Numri i personelit ndihmës akademik me karakter mësimor në funksion të programit të studimit.	1 staf ndihmës akademik (laborante)
Nëse programi i propozuar është interdiciplinor, identifikoni personelin akademik që vjen nga departamente apo fakultete të tjera	<i>Departamenti i Edukimit:</i> Dr. Fatlinda Shkurti Dr. Esmeralda Laçi Dr. Enkelejda Billa <i>Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë:</i> Prof. Dr. Bardhosh Gaçe <i>Departamenti i Drejtësisë:</i> Dr. Aulona Haxhiraj <i>Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Shkencave Teknike:</i> Dr. Roneda Muçaj <i>Departamenti i Kujdesit Shëndetësor, Fakulteti i Shëndetit Publik</i> Dr. Xhuljana Xhindoli

d) Infrastruktura akademike në funksion të programit

Numrin dhe sipërfaqet e auditorëve	Fakulteti i Shkencave Humane, godina B, ka një sipërfaqe prej 3040 m². Për akomodimin e studentëve dhe lehtësim në gjetjen e sallave të lira procesi mësimor është organizuar në dy orare të ndryshme prej orës 0800 deri në orën 1400 studentët e ciklit të parë Bachelor në Gjuhë të Huaj , duke iu krijuar mundësinë, e përdorimit të mjediseve si biblioteka, laboratore, kënd leximi jo vetëm gjatë këtij orari, por edhe më tej. Sipas vendimit Nr. 418, datë 10.05.2017 "Për standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen,
------------------------------------	---



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

	riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë" Aneksi I/C për normativat e sipërfaqes së shfrytëzueshme e ndarë sipas fushave të studimit për shkencat humane është 2.5 m². Klasat në dispozicion të mësimit: <u>Kati i parë:</u> Klasa 101 (70 m²) Klasa 109 (70 m²) Klasa 112 (40 m²) Klasa 111 (40 m²) Klasa 110 (60 m²) <u>Kati i dytë:</u> Klasa 215 (70 m²) Klasa 216 (70 m²) Klasa 217 (50 m²) Klasa 201 (60 m²) <u>Kati i tretë:</u> Klasa 308 (110 m²) Klasa 307 (70 m²) Klasa 305 (70 m²) Klasa 304 (40 m²) Klasa 301 (60 m²) <u>Kati i katërt:</u> Klasa 412 (60 m²) Klasa 407 (40 m²) Klasa 409 (110 m²) Klasa 404 (90 m²) Klasa 402 (50 m²) Klasa 401 (60 m²)
Laboratorët dhe mjediset për realizimin e praktikës profesionale.	Fakulteti i Shkencave Humane zotëron gjithsej 3 laboratorë (edukim, pedagogji, gjuhë e huaj), nga të cilët 2 laboratorë i përkasin Departamentit të Edukimit dhe një Departamentit të Gjuhëve të Huaja. Laboratorët janë të mirë pajisur me materiale didaktike, videoprojektorë dhe kompjutera (i gjuhëve të huaj). Mjedise të tjera në funksion të realizimit të programit janë biblioteka e fakultetit (90m²) dhe këndi i leximit i Departamentit të Gjuhëve të Huaja (40m²).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

**Bibliotekë, numrin e titujve,
numrin e posteve të leximit, e-
library**

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë ka në dispozicion të studentëve, pedagogëve, studiuesve dhe stafit 3 (tre) biblioteka me 3 (tre) salla leximi, me personel 4 (katër) vetë, me vendndodhje, përkatësisht: Biblioteka qendrore, në Godinën A (Rektorati), që mbulon dhe Fakultetin e Ekonomisë me personel 2 (dy) specialistë, Biblioteka B, në Fakultetin e Shkencave Humane me 1 (një) specialist (që mbulon edhe Fakultetin e Shëndetit Publik) dhe Biblioteka e re në godinën C, në Fakultetin e Shkencave Teknike me 1 (një) specialist/e. Sektori i Bibliotekës Shkencore është njësi ndihmëse e Universitetit, strukturë ndihmësakademike me karakter administrativ në nivel institucioni dhe është në vartësi të Rektorit, sipas organigramës, nëpërmjet zv/rektorit akademik dhe ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimnxënies/ mësimdhënies dhe/ose të kërkimit shkencor dhe/ ose të zhvillimit të institucionit të arsimit të lartë (Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë).

Numri i vendeve për sallë përkatësisht: Total - 120, Biblioteka A - 60, Biblioteka B - 37, Biblioteka C - 23. Numri i përdoruesve/ frekuentuesve: Total - 80, Biblioteka A - 45, Biblioteka B - 20, Biblioteka C - 15. [Në raportin e vetëvlerësimit të institucionit, kapaciteti i Bibliotekës A ishte 70, por këtë vit akademik (2019-2020) në mjediset e Bibliotekës Qendrore (Godina A) u krijua Akriva e Bibliotekës dhe hapësira e vendeve të studimit u ngushtua në 60 kapacitetet 60 vende studimi në sallë, që deri më sot e përballon numrin e përdoruesve që frekuentojnë Bibliotekën].

Koeficienti i shfrytëzueshmërisë, [logaritur me numrin e përdoruesve të bibliotekës mbi numrin e vendeve në çdo sallë (total bibliotekat)] është afërsisht 0.67 ose 67 % shfrytëzohet. Sipërfaqja e bibliotekës A është 252 m². Aty u krijua sipas standardeve dhe në mjedisin e duhur për Arkivin e Bibliotekës. Sipërfaqja e bibliotekës B është 90 m², ndërsa Sipërfaqja e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

bibliotekës C është 80 m².

Pasurimi i fondeve të bibliotekës sigurohet përgjithësisht me pasurim korrent dhe më pak me pasurim retrospektiv. Burimet e pasurimit për librin në gjuhën shqipe janë: blerjet me procedurë sipas buxhetit të përcaktuar me preventivat dhe specifikimeve teknike, miratur nga S.A dhe B.A. [me tenderim], dhe dhuratat nga institucione shtetërore, organizata jofitimprurëse apo persona private, për tekste që paraqesin interes për studentët, pedagogët e stafin. Për librin e huaj nëpërmjet burimeve të ndryshme të pasurimit që gjenden në internet. Një adresë e tillë që është shfrytëzuar është: <http://www.amazon.com> apo Barnes & Noble company <http://barnesandnoble.com>

Biblioteka funksion me fonde të hapura (salla leximi - të tri bibliotekat) dhe me fonde të mbyllura (biblioteka qendrore).

Në total, fondi i trashëguar (1994-2016 (me blerje dhe dhurata, shqip dhe në gjuhë të huaj) është: 35. 000 tekste në kopje (copë) për rreth 15.000 tituj, nga të cilat blerje janë 29.730 kopje për 10.883 tituj, përkatësisht në Bibliotekën A - 16.048 kopje për 6.179 tituj, në Bibliotekën B - 13.682 kopje për 4.704 tituj. [Biblioteka C është hapur më 28.03. 2018].

Nga vitj 2016-2019 janë bërë 2 (dy) blerje, të cilat kanë pasuruar burimet manuale të bibliotekës dhe e kanë freskuar ndjeshëm atë nëpërmjet përditësimit të literaturës, në shërbim të mbështetjes efektive të mësimi dhe hulumtimit të studentëve.

- Për vitin akademik 2016-2017, (në dhjetor 2017) koleksioni i bibliotekës pasurohet 408 tituj, nga të cilët 231 në gjuhën shqipe dhe 177 në gjuhën angleze me 4160 vëllime në total, nga të cilat 3868 shqip, 291 anglisht dhe 1 në italisht.

-Për vitin akademik 2017- 2018 koleksioni i



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

bibliotekës pasurohet me 160 tituj, nga të cilët 71 shqip, 89 anglisht, në 3224 vëllime nga të cilët shqip 3120, anglisht 104.

Për bibliotekën online dhe atë digjitale:

1. Në softin Cobib.al për digjitalizimin e katalogut bibliografik të koleksionit të Bibliotekës përditësojmë tekste dhe artikuj shkencorë si pjesë e rrjetit në sistemin ndërkombëtar Cobis. Net. Studentët kanë kërkuar për materiale/ tekste, artikuj digjitalë sipas manualit të librarisë digjitalë, i cili ka shërbyer për të aksesuar shërbimin e librarisë digjitalë, duke aksesuar këtë shërbim në linkun: <https://ulibrary.rash.al/>

2. Për Bibliotekën elektronike online është punuar me burimet elektronike për Shqipërinë [(Electronic Resources for Albania (ERA2012 Project)], mbështetur nga IZUM/ Qendra Rajonale për Sistemet e Informimit Bibliotekar dhe Sistemet e Informacionit Kërkimor ee.cobis.net; EIFL/ Informacioni Elektronik për Biblioteka ee.eifl.net dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë/ koordinatori për projektin ERA 2012 ee.akad.edu.al/era ku studentët dhe pedagogët kishin akses në informacion me tekst të plotë nga ebrary Academic Complete, EBSCO Academic Search Premier, Emerald Management e Journal Collection, Multi-Science Journals Collection, ProQuest Central, Taylor & Francis library dhe shumë më tepër.

3. Për digjitalizimin e standardizuar dhe të unifikuar të librit/ tekstit mësimor apo artikujve shkencorë të nevojshëm jemi në proces unifikimi me rrjetin e Bibliotekave Universitare me lider Bibliotekën e Akademisë së Shkencave, me synimin e një plani kombëtar për digjitalizimin e Bibliotekave Universitare dhe atyre të rrjetit, me një politikë kombëtare dhe universitare për digjitalizimin e bibliotekave shkencore si për digjitalizimin e tekstit nga botuesi/ enti botues dhe për tekstin e digjitalizuar nga specialist i Bibliotekës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

Zyrën për stafin akademik dhe ndihmësakademik	<i>Stafi akademik:</i> • 1 zyrë për drejtuesen e departamentit • 2 zyra për stafin akademik të Departamentit të Gjuhëve të Huaja, 1 zyrë për stafin e grupit mësimor/kërkimor të histori-gjeografisë, 1 zyrë për grupin mësimor të letërsisë, 1 zyrë për Departamentin e Drejtësisë <i>Stafi ndihmësakademik:</i> • 1 zyrë për sekretarinë mësimore • 1 zyrë për kryesekretarinë • 1 zyrë për shërbimin ndaj studentëve
--	---

e) Programet e përbashkëta

Burimet financiare	
Kontribut i partnerëve	
Vënia në dispozicion e burimeve nga partnerët	
Administrimi i programit	
Lëshimi i diplomës dhe lloji (diplomë e përbashkët/e dyfishtë/ e shumëfishtë)	
Të dhëna mbi aktin e themelimit/licencimit të institucionit partner në vendin e origjinës	
Të dhëna mbi aktin e akreditimit të institucionit partner ose të programit të studimit	
Dokument zyrtar bashkëpunim mes palëve, marrëveshja kuadër	
Marrëveshja specifike për programin konkret të studimit	

f) Analizë e tregut të punës

Ndryshimi dhe avantazhet potenciale të programit të propozuar për hapjen /riorganizim në lidhje me programet e ngjashme të studimit të ofruar nga IAL të tjera.

Duke iu referuar të dhënave të paraqitura më sipër, si dhe programit të qeverisë (2017-2021), i cili në një nga pikat prioritare në fushën e turizmit ka edhe investimin në dije dhe aftësi e cila synon nxitjen e një force punëtore me arsimin dhe aftësitë e duhura në sektorin e turizmit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

duke theksuar edukimin dhe trajnimin e vazhdueshëm të personelit në të gjitha nivelet, Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023, <http://www.mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Kombëtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>), e cila vë theksin tek rritja e cilësisë së shërbimeve në turizëm, ndër të tjera, përmes një sistemi eficient të formimit profesional, e shohim me vend hapjen e një programi me karakter profesional në “Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut”.

Në nivel kombëtar, në Republikën e Shqipërisë, institucionet e arsimit të lartë, të cilat ofrojnë programe me karakter profesional në udhërrëfim turistik ose në disiplina të afërta me figurën profesionale të udhërrëfyesit turistik janë:

Universiteti “Eqerem Cabej”, Gjirokastrë ofron program studimi me karakter profesional në “Udhërrëfyes turistik”.

Universiteti “Aleksander Xhuvani”, Elbasan ofron program studimi me karakter profesional në “Operator turistik në gjuhë gjermane”.

Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër ofron program studimi me karakter profesional në “Udhërrëfyes turistik dhe menaxhues i itinerareve turistike për rajonin verior”.

Krahasuar me programet e sipërcituara, programi që propozojmë ka këto avantazhe:

1. Është program i plotë ndërdisiplinor që mundëson formim profesional me njohuri për gjeografinë e historinë e vendit/rajonit të jugut, itineraret turistike, teknikat e udhërrëfimit, trashëgiminë kulturore e disiplina të tjera komplementare, si dhe formim të kompetencave shoqëruese dhe thelbësore për shërbim cilësor në udhërrëfim që janë kompetenca komunikuese, ndërkulturore dhe njohja e dy gjuhëve të huaja.
2. Përmban një kurrikul të bazuar në kompetenca (bazë, gjuhësore, profesionale, metodologjike, kulturore, ndërkulturore dhe qytetare, etike dhe hulumtuese), të rëndësishme për figurën e udhërrëfyesit.
3. Vë theksin në mënyrë të veçantë tek formimi i aftësive komunikuese dhe ndërvpruese në një kontekst ndërkulturor.
4. Siguron një formim profesional dhe të plotë në një kohë të shkurtër (1 vit akademik, 2 semestra, 60 kredite).

Përvoja shumëvjeçare e UV-së në fushën e turizmit, oferta dhe kapacitetet akademike të UV-së, nevoja në rritje për të licensuar në tregun turistik, figura profesionale e udhërrëfyesit turistik, kërkon formim ndërdisiplinor dhe UV i ka këto kapacitete, pasi ka staf të kualifikuar, programe të ndryshme e komplementare, të cilat shërbejnë në formimin e kësaj figure profesionale.

Meqënëse kjo figurë i referohet *par excellence* turisit të huaj, përparësia numër një e figurës së udhërrëfyesit është gjuha e huaj dhe shumë nocione duhet të merren në gjuhë të huaj,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

prandaj sugjerohet që programi për këtë figurë profesionale edhe pse ndërfakultetor, të ketë kurse në gjuhë të huaj dhe shumica e nocioneve të merren në gjuhë të huaj në mënyrë që të kenë aftësi të komunikojnë me të folmën e sektorëve të veçantë. Kurset e tjera do të zhvillohen në gjuhën shqipe. Duke qenë se 92.4% të të gjithë turistëve në Shqipëri vijnë nga Evropa (Strategjia, fq. 5), është e rëndësishme që udhërrëfyesit të aftësohen në dy nga pesë gjuhët kryesore të BE-së, nga të cilat gjuhë e parë anglishtja dhe gjuhë e dyte një nga këto: italisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht.

Trendi vendas dhe rajonal i punësimit në sektorin ku bën pjesë programi i studimit, referuar burimeve zyrtare si INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, organizma ndërkombëtarë, etj.

Në raportimin e INSTAT "Turizmi në shifra" (2019, fq. 16, http://www.instat.gov.al/media/5529/turizmi-ne-shifra_.pdf), për vitin 2018, të ardhurat e shtuara të gjeneruara nga aktivitetet e lidhura me turizmin ishin 45 miliard lekë ose 2.8% e PPB, nga të cilat 5,6 miliardë vinin nga agjenci udhëtimi, operatorë turistikë, qira e makinave dhe të tjera aktivitetetë shërbimit të rezervimit. Duke qenë se tendenca është në rritje për këto shërbime, edhe kërkesat për vende pune në këto sektorë shërbimesh është në rritje. Po ashtu, rritje ka pësuar në 2018, edhe numri i vizitorëve në kala dhe monumete të tjerë me 53.4 %, i ndjekur nga numri i vizitorëve në muze me 51,2 %, krahasuar me vitin 2017. (Po aty, fq. 20) Duke kuptuar këtë trend në rritje, lind natyrshëm domosdoshmëria e pasjes së burimeve njerëzore profesioniste në këtë sektor. Për të përfortuar këtë konstatim, në raportin e INSTAT për tregun e punës 2018, sektori i shërbimeve ka pasur përqindjen më të lartë të punësimeve me 42, 9%, kurse në 2019 pësoi një rritje të ulët me 0,2 % (INSTAT, <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-punes-dhe-arsimi/punesimi-dhe-papunesia/>). Për 2020, nga të dhënat për tremujorin e parë, rezultoi se sektori i shërbimeve ka pësuar rënie me 0,3 %²¹.

Nga një analizë e tregut të punës për 2019²², rezultoi se për qarqet e rajonit të jugut, sektori i shërbimeve zë një përqindje të konsiderueshme në punësim dhe më të lartën në punësim për qarkun e Vlorës (40%).

Bazuar në të dhënat e WTTC (World Travel and Tourism Council), për 2018, turizmi zuri 25, 2 % të punësimit total në vend (<https://www.wttc.org/economic-impact/country-analysis/country-data/>). Edhe pse në terma sasiorë, vlerësohet dhe pohohet potenciali i turizmit për të gjeneruar vende pune, ndër to edhe udhërrëfyes, kjo sjell nga ana tjetër nevojën e domosdoshme për arsimim dhe trajnim të punonjësve të sektorit turistik me qëllim ofrimin e shërbimeve profesionale vizitorëve (Strategjia, fq. 12).

²¹ INSTAT, 2020. "Anketa Tremujore e Forcave të Punës". Fq.3. <http://www.instat.gov.al/media/7151/atfp-t1-2020.pdf>.

²² INSTAT, 2019. "Tregu i Punës 2019". <http://www.instat.gov.al/media/6942/njoftim-per-media-lle-vizore-2019-shqip.pdf>.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

Në faqen web të Bashkisë Vlorë ka një listë të pasuruar të destinacioneve turistike: vende dhe zona për t'u vizituar që i përkasin trashëgimisë natyrore e kulturore. Frekuentimi i këtyre zonave turistike nga turistët kërkon burime njerëzore të kualifikuara për të shoqëruar grupet turistike në këto zona.

Nga të dhënat e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ka një interesim të shtuar për turizmin kulturor dhe atë natyror. Numri total i vizitorëve në institucionet kulturore për muajin janar 2020 ka pasur një rritje prej 6.8% krahasuar me po të njëjtin muaj vitin e kaluar. Rritja më e madhe ka qenë në parqet arkeologjike në vend (68%). Po të konsiderojmë që pjesa më e madhe e këtyre parqeve ndodhet në rajonin e jugut (Apoloni, Bylis, Amantia, Butrint, Finiq, Orikum), nevoja për udhërrëfyes profesionistë është e ngutshme. Po ashtu, sipas të dhënave nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, cituar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në janar 2020, rreth 717,903 vizitorë vendas dhe të huaj kanë vizituar këto zona²³.

Pandemia botërore e shkaktuar nga COVID-19 pati efekte të ndjeshme në ekonomi, sidomos në sektorin e turizmit, gjë e cila diktoi një sjellje drej asaj që u quajt "turizëm patriotik", dhe orientoi më shumë sektorin drejt turizmit rajonal²⁴. Në këtë kontekst, shumë operatorë të huaj dhe profesionistë të licensuar u përshtatën me një qasje të re ndaj turizmit, atë të turizmit virtual, duke adaptuar realitetin virtual (VR)²⁵ si një zgjidhje të menjëhershme për turizmin²⁶. Në një kontekst kombëtar e lokal, kjo përshtatje do të kërkonte kapacitete njerëzore profesionale dhe të pajisura me aftësi digjitale për një realitet të tillë. Programi i propozuar e ngërthen edhe një dimension të tillë përmes kursit të propozuar në kurrikul: Përdorimi i TIK në udhërrëfim.

Nevoja e përmbushur e tregut të punës që plotëson programi i ri/riorganizuar i propozuar nga IAL-ja.

Siguron një formim të plotë, mbështetës dhe profesional në fushën e turizmit. Ai i përgjigjet problemeve të identifikuara në *Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023*, konkretisht, informalitetit në veprimtaritë turistike, ndër to edhe në

²³ Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. 2020. *Buletini i turizmit*, Fq. 6-7. <http://www.mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2020/06/BULETINI-I-TURIZMIT-JANAR-2020.pdf>.

²⁴ Gjatë këtij sezoni turistik 2020, pati më shumë vizitorë/turistë vendas apo nga rajoni (Kosovë, Maqedoni e Veriut, Mal i Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi), por nuk munguan turistët polakë dhe ata bjellorussë e ukrainas. (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. 2020. "Klosi: Ky ishte viti i turizmit patriotik dhe rajonal". <http://www.mjedisi.gov.al/klosi-ky-ishte-viti-i-turizmit-patriotik-dhe-rajonal/>.)

²⁵ Rogers, Sol. 2020. "How Virtual Reality Could Help The Travel & Tourism Industry In The Aftermath Of The Coronavirus Outbreak". Forbes. <https://www.forbes.com/sites/solrogers/2020/03/18/virtual-reality-and-tourism-whats-already-happening-is-it-the-future/#3e78ec1e28a6>.

²⁶ Sipas WTTC (Këshillit Botëror për Udhëtim dhe Turizëm), pandemia botërore mund të sjellë një shkurtim deri në 50 milionë vende pune në mbarë botën në industrinë e turizmit dhe udhëtimit. (World Economic Forum. 2020. "This is how coronavirus could affect the travel and tourism industry". <https://www.weforum.org/agenda/2020/03/world-travel-coronavirus-covid-19-into-pandemic-tourism-aviation/>.)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

shërbimin e udhërrëfimit, shërbimit me cilësi të ulët (fq. 13), mungesës së trajnimit të të punësuarve në sektorin e turizmit (fq. 13).

Ky program përveç se përgatit specialistë në udhërrëfim turistik, ai mundëson edhe rritjen e kapaciteteve njerëzore të aftë për përmbushjen e objektivit të strategjisë për hartimin e kornizës së kualifikimeve e rishikimin e kurrikulave "në mënyrë që më pas të procedohet me trajnimin e gjithë profesioneve të lidhura me turizmin si edhe të banorëve të zonave turistike" (Strategjia, fq. 19).

Strukturat në dispozicion të studentëve për të bërë ndërlidhjen me tregun e punës si dhe burimet financiare në dispozicion të këtyre strukturave.

Struktura në dispozicion të studentëve për të bërë ndërlidhjen me tregun e punës është Drejtoria e Edukimit, Sektori i Këshillimit të Karrierës, Alumnit dhe Aktiviteteve Kulturorë-Sportive.

Burimet financiare në dispozicion të këtyre strukturave janë të ardhurat e vetë institucionit.

Punësimi potencial i studentëve

Ky program studimi krijon mundësinë për të punuar në institucione shtetërore e private, kompani dhe ente të ndryshme private, agjenci të licënuara turizmi, agjenci udhëtimi, muzeume, hotele etj. të cilat kanë nevojë për specialistë në fushën e turizmit, të aftë për të punuar si udhërrëfyes turistikë, të aftë për të bërë paraqitje të mirë, korrekte e profesionale në punë, për të nisur dhe zhvilluar komunikim profesional me vizitorë vendas dhe të huaj, të interesuar në pasuritë natyrore dhe kulturore të vendit, si dhe me përfaqësues të enteve, kompanive, agjencive apo institucioneve të tjera të ngjashme nga vende e kultura të tjera. Ky program i përgjigjet kërkesave të kohës për specialistë në udhërrëfim turistik, të aftë dhe profesionistë, me formim të bazuar në kompetenca, në gjendje të komunikojnë dhe japin informacion të vlefshëm rrjedhshëm dhe saktë në të paktën dy gjuhë të huaja, për të mundësuar licensimin në dy gjuhë të huaja, si dhe të zotë nga pikëpamja ndërkulturore për të ndërvepruar dhe bashkëvepruar suksesshëm në një kontekst gjithnjë e më shumë ndërkulturore, ndërkombëtar e global.

Marrëveshje/ kërkesa paraprake nga operatorë privatë/institucione publike për punësim eventual të studentëve pas diplomimit

Në mbështetje të realizimit të komponentëve mësimore që ngërthen programi, sidomos komponentin e praktikës, por edhe për të mundësuar punësimin eventual të studentëve pas diplomimit, janë nënshkruar këto marrëveshje nga njësia kryesore:

1. Marrëveshje e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë me Bashkinë Vlorë, që nënkupton përfshirjen e gjithë institucioneve ndërvarese të saj në fushëveprimin e kësaj marrëveshjeje. (17.06.2019, nr. 775/2 prot.)
2. Marrëveshje e Fakultetit të Shkencave Humane me Drejtorinë Rajonale të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCËVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

- Trashëgimisë Kulturore. (31.01.2020, nr. 62 prot.)
3. Marrëveshje e Fakultetit të Shkencave Humane me Muzeun Kombëtar "Pavarësia". (31.01.2020, nr. 63 prot.)
 4. Marrëveshje e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë me Shoqatën historike-kulturore "Amantia". (maj 2017)
 5. Marrëveshje e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë me Dhomën e Tregtisë, Vlorë. (... , nr. ... prot.)

Referenca

AKAFP. *Korniza Shqiptare e Kualifikimeve*. <http://www.akafp.gov.al/kualifikimet-profesionale/korniza-shqiptare-e-kualifikimeve/>.

Bashkia Vlorë. Projekti "Zona historike". <http://vlora.gov.al/2019/10/16/9084/>.

Bashkia Vlorë. <http://vlora.gov.al/turizem/>.

Bashkia Vlorë. <http://vlora.gov.al/turizem/informacion-per-vizitoret/>.

Bashkia Vlorë. *Turizmi/Çfarë të vizitoni*. <http://vlora.gov.al/turizem/informacion-per-vizitoret/>.

Ministria për të mirat dhe aktivitetet kulturore. Dekret ministror nr. 565, 11.12.2015, <http://www.essedraformazione.it/sites/default/files/DM-del-11-dicembre%202015-imported-56247.pdf>.

Këshilli i Ministrave. VKM nr. 692, datë 5.10.2016 "Për miratimin e rregullores 'Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre'". <http://eeë.mjedisi.gov.al/licensa-certifikata-leje/>.

Këshilli i Ministrave. VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elemente e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë". <https://univlora.edu.al/ep-content/uploads/2018/02/VKM-nr.-41-date-24.1.2018.pdf>.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". http://arsimi.gov.al/ep-content/uploads/2018/08/AKTET_NENLIGJORE.pdf.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 93/2015 "Për turizmin". http://mjedisi.gov.al/ep-content/uploads/2018/02/Ligj_93-2015.pdf.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

INSTAT. Anketa e Turizmit "Strukturat Akomoduese", 2019.

<http://www.instat.gov.al/media/7331/anketa-e-turizmit-strukturat-akomoduese-2019.pdf>.

INSTAT. Lëvizjet e Shtetasve, Gusht 2020. <http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/turizmi/publikimet/2020/l%C3%ABvizjet-e-shtetasve-gusht-2020/>.

INSTAT. 2020. Popullsia e Shqipërisë. Fq. 4.

http://www.instat.gov.al/media/6849/popullsia_me-1_janar_2020.pdf.

INSTAT. 2020. "Anketa Tremujore e Forcave të Punës".

<http://www.instat.gov.al/media/7151/atfp-t1-2020.pdf>.

INSTAT. Tabela 'Studentë në arsimin e lartë sipas fushave të studimi',
<http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-punes-dhe-arsimi/arsimi/#tab2>.

INSTAT. 2018. *Turizmi në shifra*. <http://www.instat.gov.al/media/4169/turizmi-ne-shifra-2018.pdf>.

INSTAT. 2018. Anketa e Turizmit "Pushime dhe Udhëtime".
<http://www.instat.gov.al/media/6404/anketa-e-turizmit-pushime-dhe-udhetime-2018.pdf>.

INSTAT. 2019. *Turizmi në shifra*. <http://www.instat.gov.al/media/5529/turizmi-ne-shifra.pdf>.

INSTAT. 2019. *Tregu i punës dhe arsimit*. <http://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-punes-dhe-arsimi/punesini-dhe-papunesia/>.

INSTAT. 2019. "Tregu i Punës 2019". http://www.instat.gov.al/media/6942/njoftim-per-media-lfs-vjetore-2019_shqip.pdf.

MASR. Udhëzimi nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë". <https://arsimi.gov.al/udhezim-nr-27-date-29-12-2017-per-strukturat-e-brendshme-akademike-dhe-administrative-ne-institucionet-publike-te-arsimit-te-larte-2/>.

MASR. Udhëzimi nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësi kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

MASR. Udhëzimi nr. 22, datë 3.09.2020. "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë".

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. *Strategjia kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit 2019 – 2023*. <http://www.mjedisi.gov.al/ep-content/uploads/2019/06/Strategjia-Kombëtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. *Buletini i Turizmit*. Shkurt 2020. Fq. 6. <http://www.mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2020/06/BULETINI-I-TURIZMIT-SHKURT-2020.pdf>.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. 2020. "Klosi: Ky ishte viti i turizmit patriotik dhe rajonal". <http://www.mjedisi.gov.al/klosi-ky-ishte-viti-i-turizmit-patriotik-dhe-rajonal/>.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. 2020. Buletini i turizmit. <http://www.mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2020/06/BULETINI-I-TURIZMIT-JANAR-2020.pdf>.

Ministria për të mirat dhe aktivitetet kulturore. Dekret ministror nr. 565, 11.12.2015, <http://www.esedraformazione.it/sites/default/files/DM-del-11-dicembre%202015-imported-56247.pdf>.

Parku Kombëtar Detar Karaburun-Sazan. 2018. *Buletini Informativ*, nr. 1, <https://www.karaburunsazanmpa.com/attachments/article/17/ZMD%20Karaburun-Sazan%20Buletini%20Informativ%201.pdf>.

Qeveria e Republikës së Shqipërisë. *Programi qeverisës 2017-2021*. <https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2017/11/PROGRAMI.pdf>.

QZHQ. http://www.senior-a.al/docs/17SDGs_Shqip.pdf.

Rogers, Sol. 2020. "How Virtual Reality Could Help The Travel & Tourism Industry In The Aftermath Of The Coronavirus Outbreak". Forbes. <https://www.forbes.com/sites/solrogers/2020/03/18/virtual-reality-and-tourism-whats-already-happening-is-it-the-future/#3e78ee1e28a6>.

Sahitaj, Lavdrim. 2016. *Cilësia e burimeve njerëzore turistike, faktor kryesor në zhvillimin e turizmit në Shqipëri*. Disertacion, UET, http://uet.edu.al/images/doktoratura/Lavdrim_Sahitaj.pdf.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

Travel Magazine, revista shqiptare e turizmit rajonal,
<http://www.albaniantravel.info/AlbanianTravel/forum/item/qindra-udherrefyes-te-certifikuar-por-guidat-e-huaja-vazhdojne-te-patrazuar-te-punojne-neper-sitet-turistike-shqiptare>.

Udhëzim i përbashkët nr. 517, dt 24.01.2017. "Për akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik dhe miratimin e krediteve minimale të programit për edukimin profesional në vazhdim". <https://turizmi.gov.al/njoftim-mbi-akreditimet-e-programeve-te-kualifikimit-te-udherrefyesit-turistik/>.

MTM. Udhëzim nr. 517, datë 24.01.2017. "Për miratimin e rregullores "Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre".

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë. Statuti. <https://univlora.edu.al/statuti/>.

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë. Plan Strategjik i UV-së, 2028-2024, Vendim i Bordit të Administrimit Nr. 26, datë 8.11.2018, https://univlora.edu.al/ep-content/plugins/ari-fancy-lightbox/assets/pdfs/ceb/viewer.html?file=https%3A%2F%2Funivlora.edu.al%2Fep-content%2Fuploads%2F2018%2F11%2Fplani_dok_final.pdf#page=1&zoom=auto,-12.529.

Vlora news. "Bedinaj ka konfirmuar se problematika me të cilat haset sektori i turizmit lidhet me forcën punëtore." <https://vloranews.al/lajme/bedinaj-ka-konfirmuar-se-problematika-me-te-cilat-haset-sektori-i-turizmit-lidhet-me-forcen-punetore/>.

VKM nr. 41, datë 24.01.2018. "Për elemente e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë".

VKM nr. 692, datë 5.10.2016. "Për miratimin e rregullores "Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre".

World Economic Forum. 2020. "This is how coronavirus could affect the travel and tourism industry". <https://www.weforum.org/agenda/2020/03/world-travel-coronavirus-covid19-jobs-pandemic-tourism-aviation/>.

WTTC. 2019. ALBANIA 2019 ANNUAL RESEARCH: KEY HIGHLIGHTS, <https://www.wttc.org/economic-impact/country-analysis/country-data/>.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCËVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

SHITOJCA 1

Njohuritë dhe kompetencat/rezultatet e pritshme të të nxënës të studentëve në përfundim të programit mësimor

Në përfundim të programit të studimit, pritet që studenti të ketë përvetësuar këto kompetenca dhe rezultate të të nxënës:

A. Kompetenca bazë		Rezultatet e të nxënës të programit	
1	Kompetenca të aftësisë vetjak dhe të organizimit të pavarur	1.1.	Aftësim për të organizuar aktivitete turistike, studimore dhe profesionale në mënyrë të pavarur, për të realizuar ture e itinerare turistike dhe hulumtime rreth çështjeve të ndryshme për turizmin.
2	Kompetenca shoqërore dhe komunikuese	2.1	Aftësim për të kuptuar ndikimin që dallimet kulturore kanë në ndërveprimet shoqërore dhe për të komunikuar, ndërvepruar dhe bashkëpunuar me sukses në një mjedis shumëkulturore.
		2.2.	Aftësim për të kryer me grup të ndryshme, me kompani dhe ente turistike duke marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse
3	Kompetenca të organizimit dhe seleksionimit të informacionit	3.1.	Aftësim për të punuar me burime të ndryshme informacioni, për të vlerësuar dhe përzgjedhur në mënyrë kritike, si dhe për të përdorur në mënyrë praktike informacionin që lidhet me profesionin e ardhshëm, por jo vetëm
B. Kompetenca gjuhësore		Rezultatet e të nxënës të programit	
4	Kompetenca të përgjithshme gjuhësore	4.1.	Njohuri bazë të gjuhëve të studimit të programit që lidhen me elementet strukturore të gjuhës, funksionet e tyre, përdorimet gjuhësore, aktet e komunikimit, sjelljen e kontekst



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

			turistik dhe kulturor.
		4.2.	Aftësi për të përdorur gjuhën e huaj për qëllime të përgjithshme në komunikimin turistik në një kontekst ndërkulturor
5	Kompetenca socio-gjuhësore	5.1	Aftësi për të diskutuar me folës të gjuhëve të tjera dhe që u përkasin kulturave të tjera në mënyrë të përshtatshme dhe pa gabime në formulimin e ideve.
		5.2.	Aftësi për të komunikuar në mënyrë të përshtatshme duke zgjedhur fjalët, shprehjet dhe qëndrimin ndaj një rrethane, mjedis, temë apo marrëdhënie e caktuar.
6	Kompetenca pragmatike	6.1	Aftësi për fleksibilitet për t'u përshtatur kur në diskutim ndryshohet tema dhe stili duke përshtatur formulimet sipas rastit.
C.	Kompetenca të fushës/profesionale	Rezultatet e të nxënit të programit	
7	Kompetenca shkencore	7.1.	Formim i njohurive rreth fushave si histori, gjeografi, trashëgimi kulturore, të nevojshme për përgatitjen e udhërrëfyesve dhe interpretuesve të ardhshëm në ushtrimin e profesionit të tyre.
		7.2.	Aftësi për të mbledhur të dhëna mbi situata të ndryshme turistike me qëllim kryerjen e studimeve dhe analizave duke zbatuar metoda të ndryshme kërkimore.
8	Kompetenca metodologjike dhe profesionale	8.1.	Aftësi për të përdorur teknikat e ndryshme të udhërrëfimit në përshtatje me llojet dhe situatat e ndryshme të udhërrëfimit.
		8.2.	Aftësi për të krijuar itinerare dhe guida turistike duke u nisur nga nevojat e vizitorëve.
		8.3.	Njohje të legjislacionit për turizmin.



REPUBLIKË E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCËVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

9	Kompetenca teknologjike	9.1.	Aftësi për të përdorur teknologjinë dhe mundësitë që ofron ajo gjatë udhërrëfimit dhe promovimit të turizmit dhe trashëgimisë kulturore.
10	Kompetenca kulturore	10.1	Njohuri rreth kulturës dhe historisë së vendit, si dhe rëndësisë e rolit të tyre për qëllime turistike, si dhe vendosjen e tyre në një kontekst më evropian dhe global.
		10.2	Aftësi për të analizuar dukuri kulturore dhe vendosur ato në kontekste ndërkulturore.
		10.3	Aftësi për të mbledhur dhe analizuar të dhëna letrare e kulturore për të kryer studime përfaqëse në kontekstin e turistike.
11	Kompetenca ndërkulturore dhe qytetare	11.1	Njohuri rreth çështjeve si komunikim ndërkulturore, kompetencë ndërkulturore, takime kulturore.
		11.2	Aftësi për të zbatuar kompetencën ndërkulturore në praktikë në kontekste kulturore të larmishëm.
		11.3	Njohje e koncepteve si multilinguizëm, plurilinguizëm, Evropë shumëgjuhëshe.
		11.4	Aftësi për të përdorur të gjitha këto kompetenca dhe koncepte kulturore, ndërkulturore dhe evropiane në komunikim dhe ndërveprim me vizitorë dhe turistë të huaj për qëllime udhërrëfimi dhe interpretimi turistik.
12	Kompetenca etike	12.1	Njohje e parimeve morale, standardeve të sjelljes dhe vlerave që karakterizojnë profesionin.
		12.2	Njohje e rregullave, vlerave që dëshmojnë sjellje profesionale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

PROJEKT-PROPOZIM PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Program studimi njëvjeçar me karakter profesional:

“Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut”

1. Institucioni/IAL	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë
2. Aplikimi	a. Program i ri
3. Emërtimi i programit të propozuar për hapje a. Shkruani emrin e plotë të programit	Program studimi njëvjeçar me karakter profesional në “Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut”
4. Semestri dhe viti akademik i hapjes	Viti akademik 2021-2022, semestri “Vjeshtë 2021”
5. Të dhënat për aktin e akreditimit të IAL dhe/ose njësisë kryesore që ofron programin e studimit.	Akreditimi i UV: Vendim i ASCAL Nr. 71, dt. 21.09.2017 Hapja e FSHH: VKMNr. 822, 5. 12. 2007 Vendim Senati Akademik Nr. 9/4, datë 6.07.2009
6. Vendimi i miratimit nga Senati Akademik	Vendim Nr. ..., datë 25.09.2020
Vendimi i miratimit nga Bordi Administrimit	Vendimi Nr. ..., datë ...09.2020
7. Nëse është një program i përbashkët	
8. Programi ofrohet nga/në:	Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane Kampusi/godina B
9. Të dhëna mbi personat e kontaktit përgjegjës për programin e studimit	Emër, mbiemër: Prof. as.dr. Armela Panajoti Pozicioni në IAL: dekane, Fakulteti i Shkencave Humane pedagoge, Departamenti i Gjuhëve të Huaja Tel: +355 69 2384468 E-mail: armela.panajoti@univlora.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

	Emër, mbiemër: Prof.as.dr. Frosina Londo (Qyrdeti) Pozicioni në IAL: Përgjegjës i grupit mësimor me karakter kërkimor-shkencor i Studimeve Kulturore dhe Letrare, Departamenti i Gjuhëve të Huaja Tel. +355 69 6215789 E-mail: frosinalondo@yahoo.it
10. Deklaratë e titullarit të IAL për plotësimin e standardeve akademike dhe infrastrukturore.	Shkresa Nr:
11. Firma (emër / mbiemër) e titullarit të institucionit dhe vula e institucionit.	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË PROPOZUAR PËR HAPJE/RIORGANIZIM

a) Të dhëna mbi programin e studimit

Përshkrimi i përgjithshëm i programit

Misioni: Programi i studimit me karakter profesional "Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut" është program njëvjeçar ndërdisiplinar me 60 kredite, dy semestra akademike, i cili formon specialistë në fushën e turizmit, të aftë për të punuar si udhërrëfyes turistikë, të pajisur me njohuri praktike e teorike, me njohuri të mirëfillta e të plota rreth gjeografisë, reliefit, kontekstit historik e kulturor, trashëgimisë kulturore, etnografisë së trevave në rajonin e jugut. Mbi të gjitha, ky program synon të aftësojë studentët e këtij programi me shprehje të mira gjuhësore, në gjuhën angleze dhe një gjuhë tjetër të dytë (italisht/gjermanisht/spanjisht/frëngjisht), si dhe t'i pajisë ata me kompetencën ndërkulturore dhe aftësi të larta komunikuese.

Programi është në përputhje me politikat e qeverisë shqiptare lidhur me përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në turizëm, politika të cilat synojnë formimin profesional e trajnime e kualifikime të vazhdueshme për punonjësit e strukturave akomoduese e restoranteve, për udhërrëfyesit turistikë¹ etj.

Qëllimi: Ky program synon përgatitjen e specialistëve të aftë të kryejnë detyrat e udhërrëfyesit turistik, si të punësuar apo të vetëpunësuar për të ofruar shërbime që lidhen me shoqërimin e grupeve turistike, të pajisur me njohuri e etikë profesionale, shprehje të mira gjuhësore, në gjuhën angleze dhe një gjuhë tjetër të dytë, kompetencë ndërkulturore dhe aftësi të larta komunikuese, për ofrimin e shërbimeve cilësore udhërrëfyes në strukturat turistike e akomoduese në institucionale publike dhe private.

Objektivat:

Objektivat formues të programit janë:

- Pajisja me njohuri të përgjithshme rreth historisë, gjeografisë, arkeologjisë dhe trashëgimisë dhe pasurive kulturore e natyrore të rajonit të jugut të Shqipërisë.
- Formim profesional, i plotë e bashkëkohor në teknikat e udhërrëfimit, në zbatimin e kodit të sjelljes dhe etikës personale, në shoqërimin e turistit dhe të grupeve turistike në lëvizje, në hartimin e itinerareve turistike etj.
- Aftësi për të komunikuar në dy gjuhë të huaja (anglisht dhe italisht/frëngjisht/spanjisht/gjermanisht).

¹ Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023, fq. 14.
<http://www.mjedis.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Kombetare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCËVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

• Kompetencë ndërkulturore e aftësi komunikuese si thelbësore në ndërveprimin me të huajt dhe turistët në veçanti.

Lloji i programit	Program me karakter profesional
Kohëzgjatja	1 vit
Numri i krediteve	60 kredite
Njësia bazë/njësia kryesore ofruese e programit të studimit	Departamenti i Gjuhëve të Huaja / Fakulteti i Shkencave Humane

Justifikimi i bazuar në të dhëna empirike dhe të verifikueshme për nevojën e hapjes/riorganizimit të programit

Shqipëria, e sidomos rajoni i jugut, po bëhet një atraksion turistik i vizitueshëm nga shumë turistë, vendas dhe të huaj, të cilët tërhiqen nga bukuritë e resurset natyrore, trashëgimia kulturore e historike, kuzhina, pasuria arkeologjike e tregave të këtij rajoni. Nga ana tjetër, kjo lloj tërheqjeje ka diktuar një qasje më vepruese për diversifikimin e atraksioneve e itinerareve turistike (krijimin/rikonceptimin apo rimëkëmbjen e qendrave historike në qytete, promovimin e fshatrave turistike, siteve arkeologjike, monumenteve të kulturës, zbulimin e destinacioneve të reja turistike, muzeve etj.) në rajonin e jugut të Shqipërisë, në përputhje edhe me strategjinë e qeverisë për rivitalizimin e qendrave urbane, e fshatrave turistike, gjë e cila kërkon, në radhë të parë, përmirësim të shërbimeve turistike e mikpritëse. Në këtë kontekst, kjo dikton nevojën për udhërrëfyes të certifikuar, të aftë profesionalisht, të pajisur me njohuri rreth historisë, gjeografisë dhe trashëgimisë dhe pasurive kulturore e natyrore të vendit, me shprehje të mira komunikuese, etikë profesionale, përgjegjshmëri, korrektesë, aftësi për të komunikuar e kryer shërbimin e udhërrëfimit në gjuhë të huaja etj.

Si një nga prioritetet kryesore të Programit² të qeverisë shqiptare dhe si një nga promotorët e zhvillimit ekonomik të vendit, turizmi ka sjellë nevojën për plotësim ligjor e shërbime cilësore, sidomos në ato të shoqërimit dhe udhërrëfimit. Kuadri ligjor në fushën e turizmit (ligji nr. 93/2015 "Për turizmin", VKM nr. 692, datë 5.10.2016 "Për miratimin e rregullores "Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre") ka formalizuar ndjeshëm ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfimit, duke e kthyer atë në një nga profesionet më të reja në vend. I konsideruar 'ambasador' i vendit, udhërrëfyesi merr kështu një rol tepër të rëndësishëm jo vetëm në promovimin e vlerave, traditave, trashëgimisë kulturore dhe natyrës së vendit, por

² <https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2017/11/PROGRAMI.pdf>, i vënë në fokus edhe përmes "Strategjisë kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit 2019 – 2023" (<http://www.mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Kombëtare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>) për 2017-2021 (fq. 13)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

edhe në mbështetjen për qëndrueshmëri në këtë sektor me rëndësi për vendin, veçanërisht për rajonin e jugut, i cili vizitohet masivisht kryesisht për rivierën e bukur, pasuritë e bukuritë natyrore, por edhe për atraksionet e tjera turistike si vende historike dhe arkeologjike, muze, monumente kulture e atraksione të tjera me vlera kulturore³.

Megjithatë, cilësia e shërbimeve në këtë drejtim, mungesa e forcës punëtore të kualifikuar⁴, janë aspekte që mbeten ende për t'u përmirësuar jo vetëm në formalizimin e mëtejshëm, por edhe në rritjen e kapaciteteve njerëzore⁵ përmes programeve të studimit që formojnë profesionistë⁶ në këtë drejtim. Kryesisht, ky formim nënkupton zotërimin e njohurive të sakta dhe të plota për rajonin e jugut dhe nivel gjuhësor në gjuhë të huaj⁷, kryesisht në gjuhën angleze që lejon ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfimit.

Nga një vëzhgim i ofertës trajnuese/akademike në vend në këtë drejtim, vihet re që theksi i formimit është tek njohuritë për vendin dhe profesionin dhe mungon ose është i pamjaftueshëm formimi në gjuhë të huaj, komunikim e zhvillim i kompetencës ndërkulturore. Nisur nga konstatime të tilla, Departamenti i Gjuhëve të Huaja, realizoi një analizë nevojash në këtë kuadër për të mbështetur domosdoshmërinë e çeljes së këtij programi studimi me karakter profesional, duke u bazuar në:

-kuadrin ligjor në fuqi në lidhje me formimin e figurës profesionale të udhërrëfyesit turistik në nivel ndërkombëtar, rajonal, dhe kombëtar, si dhe mundësitë e punësimit të kësaj figure;

³ Sipas anketës së turizmit për strukturat akomoduese për 2019, numri i vizitorëve në rajonin e Jugut mbetet ende më i larti në vend (465.970 vizitorë). Numri më i lartë në netë qëndrimi mbetet sërish në afërsi të zonave bregdetare (58.8%) dhe rajoni më i frekuentuar mbetet ai i jugut (33.8%). (INSTAT. Anketë e Turizmit "Strukturat Akomoduese", 2019. <http://www.instat.gov.al/media/7331/anketa-e-turizmit-strukturat-akomoduese-2019.pdf>)

⁴ Vlora news. "Bedinaaj ka konfirmuar se problematika me të cilat haset sektori i turizmit lidhet me forcën punëtore." <https://vloranews.al/lajme/bedinaaj-ka-konfirmuar-se-problematika-me-te-cilat-haset-sektori-i-turizmit-lidhet-me-forcen-punetore/>.

⁵ Sahitaj (2016: 42) ndër problemet përmend mungesën e udhërrëfyesve kompetente, me njohuri për kulturën, qytetet, atraksionet, aktivitetet. Ai përmend nevojën për një politike të konsoliduar në lidhje me certifikimet dhe kualifikimin e udhërrëfyesve. Mandej, ai (2016:151) thekson rëndësinë e burimeve njerëzore tepër të specializuara në turizëm. Sheh si faktorin më kritik për sukses udhërrëfyesit e kualifikuar dhe të mirëtrajnuar, të cilët duhen rekrutuar dhe trajnuar. Sfidë janë aftësitë e kufizuara në gjuhë të huaj, sidomos anglisht, veçanërisht në provinca. (Sahitaj, Lavdrim. 2016. Cilësia e burimeve njerëzore turistike, faktor kryesor në zhvillimin e turizmit në Shqipëri. Disertacion, UET, http://uet.edu.al/images/doktoratura/Lavdrim_Sahitaj.pdf).

⁶ "Ngritja e një sistemi eficient të formimit të vazhdueshëm profesional të burimeve njerëzore të angazhuara në turizëm – Rritja e pritshmërisë së numrit të turistëve do të ushrojë një presion gjithnjë e më të rritur mbi burimet njerëzore dhe sidomos mbi cilësinë e shërbimeve." ("Strategjisë kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit 2019 – 2023", fq. 14, <http://www.mjedis.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Kombetare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>)

⁷ Niveli B2 sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët (VKM nr. 692, datë 5.10.2016).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

-të dhëna statistikore në lidhje me numrin e turistëve, operatorëve, figurat profesionale (analizë kërkesë – ofertë);

-oferta akademike e nevojshme në formimin profesional të figurës së udhërrëfyesit turistik kombëtar apo lokal.

Mbështetur në ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 75, pika 6, ligjin 93/2015 "Për turizmin", neni 4, pika 46, kreu IX, nenet 56-62 ku shpjegohet se çfarë është një udhërrëfyes turistik, në sa kategori e ndajmë atë, kriteret për certifikim, në VKM nr 692, dt 5.10.2016 "Për miratimin e rregullores "Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre", neni 4 "Kriteret për pajisjen me certifikatë", pika 4 citohet "...të jetë i pajisur me dokumentin që vërteton përfundimin me sukses të programit përkatës të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik, sipas kategorive dhe programeve të akredituara në përputhje me dispozitat e ligjit nr 93/2015 "Për turizmin", Udhëzimit të përbashkët nr. 517, dt 24.01.2017 "Për akreditimin e programeve të kualifikimit të udhërrëfyesit turistik dhe miratimin e krediteve minimale të programit për edukimin profesional në vazhdim" neni 6, pika 8, citohet "Përjashtohen nga detyrimi për të akreditur programet e kualifikimit për udhërrëfyes turistik sipas këtij udhëzimi institucionet e arsimit të mesëm profesional dhe të arsimit të lartë. Diplomat e lëshuara nga këto institucione njihen nga Komisioni i Standardizimit të veprimtarive turistike si dokumente kualifikimi profesional për udhërrëfyesin turistik, me kusht që programet e tyre të përmbajnë kërkesat minimale për trajnimin e udhërrëfyesve turistikë dhe programet përkatëse të kualifikimit sipas anekseve nr.1, nr. 2 dhe nr. 3.", nenit 3, pika 2 e po këtij udhëzimi ku citohet "Programet e kualifikimit të udhërrëfyesit turistik ofrohen nga subjekte të licensuara në përputhje me legjislacionin për arsimin dhe formimin profesional dhe nga personel me kualifikimin dhe eksperiencën e përshtatshme për modulin përkatës", na lind e drejta të propozojmë çeljen e programit me karakter profesional "Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut".

Më pas, grupi i punës pranë njësisë sonë, ndërmori këto hapa:

-realizoi takime e konsultime me sekretaren e Dhomës së Tregëtisë, Vlorë, përgjegjësen e Zyrës së Turizmit, Këshilli i Qarkut, Vlorë, këshilltaren e kryetarit të bashkisë për turizmin, kreun e operatorëve turistikë për jugun e vendit, për t'u njohur me situatën e sipërmarrjeve turistike dhe llojin e operatorëve turistikë, kërkesat, mangësitë e tyre, vërejtjet mbi figurat profesionale, me ekspertë juristë për kuadrin ligjor dhe nënligjor në lidhje me figurën e udhërrëfyesit turistik.

-kreu një analizë sasiore dhe cilësore për një tablo të qartë të rritjes së kërkesës turistike për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

rajonin e jugut:

Për shkak të pandemisë botërore shkaktuar nga përhapja e virusit COVID-19, viti 2020 ka sjellë një anomali në fushën e turizmit, më e prekshme nga të cilat është reduktimi i numrit të turistëve të huaj. Nga të dhënat e INSTAT për 2020⁸, rezulton se hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar në gusht 2020 janë 846.973. I krahasuar me gusht 2019, ky tregues rezulton me rënie (62,5 %), kurse shtetas të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar për gusht 2020 janë 575.559. Krahasuar me gusht 2019, ky numër ka rënë me 63,0 %. Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri në tetëmuorin 2020 është 1.745.169, duke rënë me 64,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Ndër qëllimet kryesore të vizitës, kryesore mbeten ende "personale" dhe "pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor etj."⁹. Këta tregues të ulët, nuk e zbehin aspak kërkesën që ka tregu shqiptar e veçanërisht jugu i Shqipërisë për udhërrëfyes turistikë.

Të dhënat premtuese të viteve 2018, 2019¹⁰, na tregojnë se në të ardhmen, me zbutjen e efekteve të shkaktuara nga pandemia¹¹, shifrat e lëvizjeve të turistëve në Shqipëri, e veçanërisht në rajonin e jugut, do të rriten ndjeshëm.

Përsa i përket numrit të udhërrëfyesve turistikë, në Shqipëri, rezultojnë 277 udhërrëfyes kombëtarë të certifikuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të cilët operojnë kryesisht në gjuhën angleze¹², dhe 275 udhërrëfyes lokalë që operojnë kryesisht në gjuhën angleze. Vihet

⁸ INSTAT. Lëvizjet e Shtetasve, Gusht 2020. <http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%20%ABrimet/turizmi/publikimet/2020/1%20%ABvizjet-e-shtetasve-gusht-2020/>.

⁹ Po aty.

¹⁰ Kështu sipas Anketës së Turizmit "Pushime dhe Udhëtime", për vitin 2018 (INSTAT. 2018, fq.2, <http://www.instat.gov.al/media/6404/anketa-e-turizmit-pushime-dhe-udhetime-2018.pdf>), destinacionet më të preferuara për udhëtime për qëllime personale apo biznesi në Shqipëri kanë qenë qarqet: Tiranë (27,1 %), Korçë (12,2 %), Vlorë (11,1 %) dhe Durrës (9,1 %). Për vitin 2019, përqindjet më të larta të udhëtimeve të kryera për qëllimin "Pushime dhe kohë e lirë" janë regjistruar në Vlorë (35 %) (INSTAT. 2019. "Turizmi në shifra", fq. 16, <http://www.instat.gov.al/media/5529/turizmi-ne-shifra.pdf>). Gjatë vitit 2018, numri i vizitoreve që kanë vizituar kala dhe monumete të tjerë ka pasur rritjen mesatare vjetore më të lartë me 53,4 %, i ndjekur nga numri i vizitorëve në muze me 51,2 %, krahasuar me vitin 2017. (Po aty, fq. 20)

¹¹ Një krahasim i shifrave për muajin shkurt 2020, para fillimit të pandemisë, me muajin shkurt 2019, tregon se turizmi natyror ka pasur një frekuentim në rritje, konkretisht një rritje me 94.7% për Vlorën, 43.2% për Beratin, 168.6 % për Gjirokastrën, 211.7% për Korçën të vizitorëve në zonat e mbrojtura. (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. *Buletini i Turizmit*. Shkurt 2020. Fq. 6. <http://www.mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2020/06/BULETINI-I-TURIZMIT-SHKURT-2020.pdf>.)

¹² Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Lista e udhërrëfyesve turistikë të certifikuar për kategorinë "kombëtar". <http://mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2020/08/Lista-e-udh%C3%ABr%C3%ABfyesve-kategoria-KOMBETAR.pdf>.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

Këto të dhëna përfocojnë edhe njëherë nevojën për një program të tillë studimi. Edhe pse ka disa kurse trajnimi ose programe studimi me karakter profesional dhe/ose të nivelit "Master", mendojmë që ato nuk e plotesojnë nevojën për përgatitjen e udhërrëfyesve. Për më tepër, oferta akademike e tyre është më shumë e përqendruar tek njohuritë profesionale, ato për vendin/rajonin dhe profesionin, dhe nuk adresojnë nevojën për kompetenca gjuhësore, sidomos në gjuhë të huaj për turizmin, si dhe për kompetenca ndërkulturore, pasi profesione të tilla presupozojnë kryesisht komunikim dhe tejçim informacioni dhe njohurish kulturore në një gjuhë të caktuar në një kontekst ndërkulturor.

Në propozimin për këtë program studimi, të ofruar nga Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë në bashkëpunim me njësitë e tjera të këtij fakulteti (Departamentin e Edukimit, grupi mësimor-kërkimor i histori-geografisë, Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, Departamenti i Drejtësisë) dhe Departamentin e Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Shkencave Teknike, si dhe Departamentin e Kujdesit Shëndetit, Fakulteti i Shëndetit Publik janë mbajtur parasysht:

- a) Nenet 75, 76 në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë";
- b) Ligji nr. 93/2015 "Për turizmin";
- c) Korniza Shqiptare e Kualifikimeve;
- d) Udhëzimi nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë";
- e) Udhëzimi nr. 22, datë 3.09.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë";
- f) VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elemente e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë";
- g) VKM nr. 692, datë 5.10.2016 "Për miratimin e rregullores "Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre";



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCËVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

h) Udhëzimin nr. 517, datë 24.01.2017 "Për miratimin e rregullores "Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, çetyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre" (neni 6, pika 8; nenit 3, pika 2);

i) Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023.

Për propozimin e këtij programeve, përveç bazës ligjore në fuqi, është mbajtur parasysh:

1. Respektimi i elementeve formues të shprehura në kredite sipas ndarjes në shtojcën I në VKM nr. 41, datë 24.01.2018.
2. Rekomandimet e dhëna nga grupi i punës, i ngritur pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja me shkresë nr. 708 prot., datë 28.09.2018, në relacionin "Mbi analizën e nevojave dhe tregut të punës për mundësinë e hapjes së një programi studimi, "Diplomë profesionale në udhërrëfim turistik" pranë Departamentit të Gjuhëve të Huaja" dhe studimin e fizibilitetit "Analiza e nevojave dhe tregut të punës për mundësinë e hapjes së këtij programi studimi.
3. Diskutimet dhe mendimet e dhëna nga Komisioni i Programeve pranë këtij departamenti.
4. Vendimi i Departamentit të Gjuhëve të Huaja, nr. 264, datë 15.09.2020, për hapjen e programit të studimit me karakter profesional "Udhërrëfyes turistik për rajonin e jugut".
3. Kurrikul e bazuar në kompetenca. Këtu jemi përpjekur të identifikojmë kompetencat që duhet të zotërojnë një udhërrëfyes turistik lokal në mënyrë që të integrohen në modulet/lëndët në këtë program, si dhe të ofrojnë lëndë që zhvillojnë këto kompetenca, duke vënë kryesisht theksin tek kompetenca ndërkulturore apo njohja e gjuhëve të huaja, si kompetenca që e bëjnë më eficientë dhe profesionale paraqitjen e udhërrëfyesve.
4. Njohja e dy gjuhëve të huaja. Këtu kemi vënë theksin tek njohja e anglishtes për qëllime turistike dhe aftësi të studentëve të këtij programi për nivelin B2 të kompetencës sipas Kuadrit Evropian të Gjuhëve, si dhe njohja e një gjuhë të dytë të huaj, sipas zgjedhjes së studentit, për të qenë në kohezion me politikat e BE-së për formimin në të paktën dy gjuhë të huaja, si dhe, mbi të gjitha për t'u përgjigjur nevojave të një tregu gjithnjë e më global.
5. Prioritetet strategjike. Në nenin 25 "Mbështetja për zhvillimin e turizmit" në ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin", një nga mënyrat për ta mbështetur turizmin është kualifikimi i burimeve njerëzore. Në *Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019 – 2023* theksohet, si në objektivat strategjike, ashtu edhe ato politike përmirësimi i shërbimeve, përmes, ndër të tjera, një sistemi të formimit të vazhdueshëm profesional, si dhe zhvillimit të arsimit profesional dhe kualifikimet në turizëm, si dhe trajnimit të burimeve njerëzore të angazhuara në sektor¹⁸.

¹⁸ Strategjia, fq. 19, <http://www.mjedisi.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/Strategjia-Kombetare-e-Turizmit-2019-2023.pdf>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

6. Trendi i turizmit. Nga raportimi i INSTAT, Turizmi në shifra 2019 (fq. 20, <http://instat.gov.al/media/4169/turizmi-ne-shifra-2019.pdf>), "Në periudhën 2014-2018 numri vizitorëve që kanë vizituar parqet arkeologjike, muzetë, dhe kala e monumentetë tjerë ka qenë afërsisht 3 milionë persona me një rritje 49,4 % për vitin 2018. Gjatë vitit 2018, numri i vizitorëve që kanë vizituar kala dhe monumente të tjerë ka pasur rritjen mesatare vjetore më të lartë me 53,4 %, i ndjekur nga numri i vizitorëve në muze me 51,2 %, krahasuar me vitin 2017. Kjo tendencë në rritje dikton nevojën për profesionistë në fushën e udhërrëfimit të pajisur me njohuri teknike, kulturore, profesionale, por edhe me aftësi komunikuese dhe ndërkulturore e gjuhësore.

Analiza SWOT e aplikimit për hapje/organizim programi

Për përgatitjen e këtij propozimi, u mor parasysh edhe analiza SWOT e realizuar për të vlerësuar së brendshmi pikat e forta dhe të dobëta dhe së jashtmi mundësitë dhe rreziqet. Të dhënat kyçe që u përdorën për këtë analizë përfshijnë:

1. Dokumentet themelore dhe strategjike të institucionit;
2. Raporti vjetor i veprimtarisë së institucionit;
3. Dokumentet strategjike të njësisë propozuese;
4. Struktura e organizimit të institucionit;
5. Burimet njerëzore në dispozicion të programit;
6. Dokumente strategjike në nivel kombëtar dhe lokal;
7. Të dhëna statistikore nga INSTAT, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Kulturës dhe burime të tjera;
8. Marrëveshjet e bashkëpunimit në këtë kuadër.

Nga shqyrtimi i dokumenteve dhe informacioneve të mësipërme, dolën në pah pikat e forta dhe mundësitë ku mund të mbështetemi për realizimin e këtij programi, si dhe dobësitë dhe rreziqet e jashtme që do të kërkojnë vëmendje nga ana jonë.

Pikat e forta

• **Qasje institucionale mbështetëse.**

Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë synon që përmes aktivitetit të tij akademik dhe shkencor të jetë në funksion të komunitetit përmes shërbimeve që sjellin zhvillim ekonomik, social dhe kulturor, në nivel kombëtar dhe rajonal (Statuti i UV-se, neni 3 "Roli dhe misioni", fq. 7, <https://univlora.edu.al/statuti/>). Sektorët ku UV synon të ketë ndikim synon të jetë drejtues dhe orientues i zhvillimit: turizmi dhe biznesi, zhvillimi social-ekonomik dhe kulturor i territorit, rritja e konkurrueshmërisë dhe marketingu i territorit, studime albanologjike dhe ballkanike. (Plani Strategjik i UV-së, 2028-2024, fq. 23, Vendim i Bordit të Administrimit Nr. 26, datë 8.11.2018, <https://univlora.edu.al/wp-content/plugins/ari-fancy-lightbox/assets/pdfs/ceb/viccer.html?file=https%3A%2F%2Funivlora.edu.al%2Fep->



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

content%2Fuploads%2F2018%2F11%2Fplani_dok_final.pdf#page=1&zoom=auto,-12,529). Një nga shtyllat e misionit strategjik të UV-së është krijimi i një profili lider "në zhvillimin e arsimit, shkencës, sportit dhe kulturës, zhvillimin territorial në tërësi". (Po aty, fq. 24) Mandej, misioni i UV-së është i orientuar edhe në dimensionin social duke synuar ndër të tjera "një rol udhëheqës në ekonominë lokale, si edhe në zhvillimin kulturor të qytetit të Vlorës dhe më gjerë". (Po aty, fq. 25). Një nga skenarët e zhvillimit në planin afatmesëm dhe afatgjatë është qenia e UV-së lider profesional. (Po aty, fq. 27)

Në planin strategjik për zhvillimin e Departamentit të Gjuhëve të Huaja 2018-2024, kjo njësi shpreh për mision të vetin formimin e studentëve me shprehje dhe kompetenca "që rrisin dhe nxisin formimin e tyre kulturor, letrar, gjuhësor, kompetencat e tyre gjuhësore, letrare, kulturore e ndërkulturore, aftësitë e të menduarit kritik dhe aftësitë për jetën, si dhe angazhimin në kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar" (Shkresë me nr. 14/1 prot., datë 14.01.2019, shtojca 4). Ndër prioritetet strategjike të kësaj njësie, është edhe krijimi i një oferte akademike profesionale (prioriteti 6, po aty).

- Stafi i kualifikuar në mbështetje të programit me përvojë të gjatë në mësimdhënie dhe kërkim.

Në këtë program studimi do të angazhohet staf nga njësitë përbërëse të Fakultetit të Shkencave Humane (Departamenti i Gjuhëve të Huaja; Departamenti i Edukimit, grupi mësimor-kërkimor i histori-gjeografisë; Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë; Departamenti i Drejtësisë). Stafi që do të angazhohet në program është staf i kualifikuar. Konkretisht, në përbërje të Departamentit të Gjuhëve të Huaja janë 6 profesorë të asociuar, 10 doktorë shkencash, 8 asistent-lektorë nga të cilët 3 doktorantë; në Departamentin e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë janë 3 profesorë, 2 profesorë të asociuar, 7 doktorë shkencash, 1 akademik i ftuar; në grupin mësimor-kërkimor të histori-gjeografisë janë 1 profesor i asociuar, 6 doktorë shkencash; në Departamentin e Drejtësisë janë 20 anëtarë të personelit akademik, nga të cilët 1 profesor i asociuar, 4 doktorë shkencash (PhD), 14 doktorë shkencash dhe 1 doktorante. Përveç stafit nga Fakulteti i Shkencave Humane, në program do të përfshihet edhe staf akademik (një) nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Shkencave Teknike, dhe nga Departamenti i Kujdesit Shëndetësor, Fakulteti i Shëndetit Publik (një anëtar). Për veprimtarinë e stafit akademik të përfshirë në program, shih CV-të e shkurtuara.

- Strukturë efektive e njësive bazë propozuese dhe e njësive kryesore në tërësi. Departamenti i Gjuhëve të Huaja është departamenti më i vjetur (çelur më 1995) në Fakultetin e Shkencave Humane, i cili u krijua nga ish Fakulteti i Edukimit (VKM Nr. 822, 5. 12. 2007, http://www.aal.edu.al/dokumente/IAL_publike/UIQ/VENDIM%20Nr.822,date%205.12.2007.pdf), pas atashimit pranë këtij fakulteti të Departamentit të Drejtësisë (Vendim Senati Akademik Nr. 9/4, 6.07.2009, shtojca 5). Numri i personelit akademik dhe ndihmësakademik përbërës të njësive të këtij fakulteti është në përputhje me ligjin nr.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

80/2015 dhe Udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017 "Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë". Fakulteti i Shkencave Humane ka katër njësi bazë (departamente) dhe një qendër kërkimore për studime albanologjike dhe ballkanike.

- Infrastrukturë në dispozicion të programit. Në dispozicion të këtij programi do të jenë të gjitha mjediset dhe facilitetet e Fakultetit të Shkencave Humane: 19 klasa, nga të cilat 13 me kapacitet për leksione dhe 6 me kapacitet për seminare; 1 bibliotekë (90 m²), 1 kënd leximi (40 m²), 3 laboratore, zyre IT, zyre shërbimesh, zyrë studenti, klinikë ligjore, sekretari mësimore, 1 qendër kërkimore (Studime Albanologjike dhe Ballkanike), 4 zyra përgjegjësish, kryesekretari, zyrë dekanit, zyrë për zv/dekanet, zyrë asistent i dekanit, zyra stafi (9).
- Bashkëpunimi i konsoliduar me partnerët/operatorët lokalë për zhvillimin e praktikave mësimore.
- Komponent i fortë praktike mësimore. Praktika do të jetë veprimtaris formuese më vete, por edhe e integruar në veprimtaritë e tjera, si lëndët: teknika të udhërrëfimit apo gjeografi turizmi.
- Mjedis lokal dhe rajonal tërheqës për zhvillimin e turizmit të llojeve të ndryshme dhe për të ushtruar veprimtarinë e udhërrëfimit. Qarku Vlorë ofron potencial të madh për zhvillimit e formave të ndryshme të turizmit: turizëm i interesit të veçantë, turizëm i diellit dhe i plazhit, turizëm i biznesit dhe kongreseve/konferencave (Bashkia Vlorë: <http://vlora.gov.al/turizem/>). Po ashtu, lista e atraksioneve turistike të qarkut është e larmishme (Bashkia Vlorë: <http://vlora.gov.al/turizem/informacion-per-vizitoret/>). Duke konsideruar faktin që numri i turistëve të huaj që vizitojnë parqet arkeologjike, muzeet, kalatë dhe monumente të tjerë ka ardhur në rritje (Gjatë 2013-2017, 2,4 milion persona me një rritje mesatare vjetore 19,5 %. INSTAT referuar të dhënave nga Ministria e Kulturës, fq. 19. <http://instat.gov.al/media/4169/turizmi-ne-shifra-2018.pdf>).

Dobësitë

- Mungesa e literaturës bazë dhe mbështetëse në gjuhën shqipe për disa disiplina specifike. Parashikohet shfrytëzimi i literaturës në gjuhë të huaj dhe tejkalimi i kësaj dobësie përmes hartimit të posaçëm të cikleve të leksioneve nga pedagogët e lëndës apo të përkthimeve të teksteve bazë në gjuhën shqipe.

Mundësitë

- Kuadri ligjor aktual për turizmin (ligji nr. 93/2015 "Për turizmin") dhe arsimin e lartë (ligji nr.80/2015) krijojnë mundësi për ofrimin e programeve me karakter profesional që i përgjigjen nevojave ekonomike, kulturore dhe sociale të qarkut dhe rajonit.
- Strategjia kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit 2019 – 2023 ka nevojë për përgjigje konkrete ndaj sfidave, problemeve, qëllimeve strategjike e politike të parashtruara, sidomos në drejtim të zhvillimit të shërbimeve të reja në turizëm, trajnimit të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I GJUHËVE TË HUAJA

burimeve njerëzore dhe krijimit të një sistemi formimi profesional. Programi i propozuar ofron zgjidhje në këtë drejtim.

- Pjesëmarrja në projekte evropiane për ngritje kapacitesh në fushën e turizmit dhe komunikimit. UV merr pjesë aktive në projekte të tilla. Pjesëmarrja në një projekt të tillë do të fuqizonte ofertën akademike të programit dhe stafin akademik përgjegjës.
- Prania e operatorëve turistikë në qark dhe shtimi i tyre në vijim do të rrisë kërkesën në treg për profesionistë në fushën e turizmit e komunikimit për qëllime turistike. Nga ana tjetër, bashkëpunimi me këta operatorë do të forcojë komponentin e praktikës duke parashikuar kështu edhe mundësi të punësimit të ardhshëm të studentëve praktikantë.
- Strategjitë për të tërhequr studentët potencialë. Përveç strategjive promovuese për njësinë dhe programin e studimit në popullatën potenciale për studentë në këtë program studimi, strategji të tjera të brendshme do të ndiqen, si: ulje e kostove të materialeve didaktike, duke përdorur forma alternative pa kosto si depozitimi i materialeve në formë elektronike dhe të vlefshme për studentët e kursit, përdorimi i burimeve të hapura didaktike (open resource), bashkëpunim i ngushtë me operatorët lokalë hap pas hapi në realizimin e programit, jo vetëm për komponentin e praktikës, por edhe për kurse specifike, program mësimor që përgatit për punësim.

Rreziqe/Kërcënime

- Konkurrenca në arsimin e lartë. Arsimi i lartë po vjen e po bëhet gjithnjë e më shumë konkurrent. Studentët bëjnë zgjedhjet e tyre bazuar në elemente të ndryshe të ofertës akademike nga institucionet e arsimit të lartë. Kjo kërkon përshtatshmëri nga ana jonë dhe studim të kërkesave të studentëve, si dhe bashkëpunim me punëdhënësit për t'i formuar studentët me shprehje pune.
- Lëvizjet migratore. Këto mund të sjellin ulje të mëtejshme të popullatës studentore. Pasja e programeve të studimit tërheqëse dhe dobiprurëse në terma ekonomike dhe personale, mund të rrisë besimin ndaj arsimit të lartë në vend.
- Ulja e lindshmërisë. Një nga rreziqet afatgjata për uljen e mëtejshme të popullatës studentore, gjykojmë që është edhe ulja e lindshmërisë.
- Lëvizjet demografike në vend. Përqendrimi i densitetit të popullsisë në kryeqytet (31.8% e popullsisë) dhe në qarqet Durrës dhe Fier (nga 10.2% secili), gjykojmë se ka sjellë ulje të popullatës studentore dhe mund të sjellë ulje të mëtejshme, nëse vijohet me këto ritme. Aktualisht, qarku Vlorë, i cili furnizon më së shumti UV-në me studentë, zë 6.6% të popullatës¹⁹.

¹⁹ Të dhënat e cituara i referohen periudhës janar 2020. (INSTAT, 2020. Popullsia e Shqipërisë. Fq. 4. http://www.instat.gov.al/media/6849/popullsia_me-1_janar_2020.pdf.)



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORI

Vlorë më, 02.11.2020

Lënda : Ngarkohen për zbatimin e shkresës bashkëlidhur në respektim të legjislacionit përkatës në fuqi :

Drejtuar:

- Senati
- Rektor
 - Qendra Studimore e Zhvillimit Rajonal
 - Sektori Juridik
 - Drejtoria e Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore
 - Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës
 - Sektori i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
 - Sektori i IT- së
- Bordi i Administrimit ✓
- Administrator
 - Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
 - Sektori i Financës dhe Realizimit të Buxhetit
 - Sektori i Prokurimeve
 - Sektori i Shërbimeve
- Njësia e Auditit të Brendshëm
- Zv. Rektor për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Insitucional
 - Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Projekteve
 - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional
 - Sektori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
 - Sektori i Promovimit Akademik dhe Kërkimeve Shkencore
- Zv. Rektor Akademik
 - Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë
 - Sektori i Kurikulave dhe Shërbimit ndaj Studentëve
 - Sektori i Këshillimit të Karrierës Alumni dhe Aktiviteteve Kulturore Sportive
 - Sektori i Bibliotekës Shkencore
- Prof. Asoc. Aurela Saliaj Dekan F.Sh.P
Kryesekretare F.Sh.P
- Prof. Dr. Albert Qarri Dekan F.E
Kryesekretare F.E
- Prof. Asoc. Armela Panajoti Dekan F.Sh.H
Kryesekretare F.Sh.H
- Prof. Asoc. Hajdar Kicaj Dekan F.Sh.T
Kryesekretare F.Sh.T

REKTOR
Prof. Dr. Roland ZISI